

SPECIALE

IVAN KRASTEV:

**Dëshirat mund të plotësohen,
por kujdes nga ajo që doni...**

Politika

Botim elektronik | ASP në bashkëpunim me Bota.al. SHTATOR 2014

Komente&Analiza nga:

Deborah McKenzie
Dominique Moisi
Olivier Faye
John Lloyd

Emma Bonino
Fareed Zakaria
Jonathan Powell
Roger Cohen etj



A kemi mbërritur në fundin e kombeve?

"Imagine there's no countries... It isn't hard to do" – "Imagjinoni të mos kishte shtete. Nuk është e vështirë" – këndonte John Lennon. Në fakt është e vështirë. Atëherë, si duhet të organizohemi? A është shteti komb një institucion i natyrshëm dhe i pashmangshëm? Apo është një anakronizëm i rrezikshëm në një botë të globalizuar?



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al



bota.al
Friday, June 20, 2014



Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Dëshirat mund të plotësohen. Por kujdes nga ajo që dëshironi

IVAN KRASTEV

“

Kriza ekonomike dhe kriza e Ukrainës janë dy çështje që e kanë ndryshuar Evropën. Dhe do të ndryshojnë mënyrën se si vepron dhe gjykon Evropa. Në impaktin politik, për herë të parë si rezultat i krizës, 50 përqind e evropianëve kanë nisur të mendojnë se brezat e tjerë do të jetojnë më keq se ç'kanë jetuar ata. Kanë pritshmëri të tjera.

Së dyti si rezultat i krizës ekonomike, po shikojmë një ndarje të re të Evropës. Tashmë jo vetëm Perëndimi me Lindjen, por më shumë Veriu dhe Jugu, vende të Eurozonës dhe ato jo të Eurozonës, dhe mbi të gjitha, tani edhe mes kreditorëve dhe debitorëve. Si rezultat i kësaj, po përballemi me një situatë të re, ku kriza po e detyron BE-në që të kërkojë institucionalisht më tepër integrim, por realisht në politikën e brendshme të saj, të flasë për më tepër kufizime dhe mbyllje.

Ky është një lajm i keq për Shqipërinë. Në një mënyrë apo tjetër, ju po bëheni pjesë e një BE-je që është krejt e ndryshme nga ajo që ishte kur hyri Bullgaria apo Rumania. Si rrjedhojë, strategjia që duhet të ndiqni ju për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian duhet të jetë e

“
Çfarë mund të thuhet në këtë situatë për Shqipërinë dhe pjesën tjetër të Ballkanit ? Deri më sot, Evropa ka qënë e fokusuar tek Shqipëria për shkak të krizës së Kosovës dhe rolit që mund të luanin ambasadorët shqiptarë. Por tashmë që kriza e Kosovës ka kaluar dhe kriza të tjera si kjo e Ukrainës kanë trokitur në portat e Evropës, vëmendja e BE-së nuk është më e njëjta. Gjithashtu, si rezultat i krizës ekonomike, situatat e brendshme kanë ndryshuar, duke bërë gjithnjë e më të fortë zërat për një mbyllje ndaj integrimit të vendeve të reja dhe integrimit të të huajve në shoqëritë evropiane
”

ndryshme nga ajo e vendeve tona. Ka disa qarqe dhe rrethana që e bëjnë më të vështirë, dhe në shumë drjtime, gjithnjë e më shumë një proces politik integrimin.

Përsa i përket krizës ukrainase, ju jeni më ekspertë se unë. Të gjithë janë kapur në befasi nga kjo lëvizje e Rusisë. Nuk ishte një sekret se, që në vitin 2010 Rusia kishte plane ushtarake veprimi për të aneksuar Krimenë, për shkak të daljes së saj në Detin e Zi dhe mundësisë së hapjes së mëtejshme të NATO-s në këto anë të Globit. Nëse Rusia do të vazhdonte ta mbante Krimenë në situatën e një konflikti të ngrirë e të vazhdueshëm, kjo nuk do të habiste askënd. Ajo që shokoi të gjithë ishte fakti që vetëm në dy javë, kufijtë e territoreve që mendoheshin tashmë të paprekshëm u ndryshuan pa ndonjë përpjekje të madhe, në sytë e gjithë botës. Në pikëvështrimin tim, kjo që ndodhi në Krime ishte një simbol mjaft i rëndësishëm për udhëheqësinë ruse, për të dëshmuar se ata nuk i nënshtrohen rendit evropian, në mënyrën se si ai funksionon aktualisht. Rendi evropian, por në një farë mënyre edhe atij ndërkombëtar. Një nga besimet më të forta që u krijuan në periudhën e pas vitit 1989, pra në rendin e pas Luftës së Ftohtë, ishte fakti që rendi evropian ishte i ndryshëm nga rendi ndërkombëtar. Evropa e ka parë veten në këtë periudhë si një territor i ndryshëm, të largët nga dhuna dhe konfliktet ushtarake, si ato që po ndodhin së fundi në Irak apo Siri. Kjo ka çuar evropianëtdrejt një bindjeje të përgjithshme, të reduktimit të shpenzimeve dhe forcës ushtarake në vitet e fundit. Situata e fundit në Ukrainë, i ka bërë shumë vende evropiane, sidomos vendet Balltike, që ndodhen edhe më pranë Rusisë, që të mendojnë ndryshe për rëndësinë e forcës ushtarake që duhet të kenë në dispozicion.

Së dyti, deri më sot ne ishim mësuar të mendonim se siguria jonë ishte e bazuar tek bashkimi. Sa më shumë të bashkuar, aq më shumë të sigurtë do të ishim. Por kjo krizë nxorri në pah se jo gjithnjë ndërvarësia ekonomike është e lidhur me ndërvarësinë e sigurisë. Gjithashtu, dolën në pah disa nga pasiguritë tona, se siguria ekonomike dhe siguria kombëtare nuk janë gjithnjë të garantuara, qoftë edhe nën një bashkim të tillë. Dhe nëse ky bashkim institucional nuk funksionon si duhet në këto dy aspekte, sigurisht që presionet për të dalë jashtë nga kjo strukturë do të shtohen.

Çfarë mund të thuhet në këtë situatë për Shqipërinë dhe pjesën tjetër të Ballkanit ? Deri më sot, Evropa ka qënë e fokusuar tek Shqipëria për shkak të krizës së Kosovës dhe rolit që mund të luanin ambasadorët shqiptarë. Por tashmë që kriza e Kosovës ka kaluar dhe kriza të tjera si kjo e Ukrainës kanë trokitur në portat e Evropës, vëmendja e BE-së nuk është më e njëjta. Gjithashtu, si rezultat i krizës ekonomike, situatat e brendshme kanë ndryshuar, duke bërë gjithnjë e më të fortë zërat për një mbyllje ndaj integrimit të vendeve të reja dhe integrimit të të huajve në shoqëritë evropiane.

Por edhe në këtë situatë mund të ketë diçka pozitive. Si rezultat i krizës ukrainase, BE e kuptoi se Ballkani ka mbetur mbrapa dhe është një rajon i pakonsoliduar. Në shumë vende të Ballkanit ka situata të tensionuara, të cilat mund të rëndohen nëse nuk trajtohen. Ju si Shqipëri mund të luani një rol të rëndësishëm në këto momente në rajon, për shkak të pozicionit tuaj të veçantë. Siç e thashë edhe më parë, integrimi evropian do të jetë gjithnjë e më shumë i ndikuar nga faktorët politikë. Dhe ju si vend, ndryshe nga fqinjët tuaj ballkanikë, nuk ndodheni në ndonjë situatë presioni për të zgjedhur mes Evropës dhe Rusisë. Presion që Rusia e ushtron tradicionalisht në disa forma me vendet e tjera të rajonit.

Pikën e fundit ku dua të ndalem, po e sjell nëpëmjet një historie ilustruese që e kam tepër për zemër. Njerëzit ndodhen shpesh në situatën që mendojnë se e dinë shumë mirë se çfarë dëshirojnë. Por në

këto situata ndryshimesh të shpejta që ndodhet Evropa, duhet të jesh shumë i kujdesshëm se çfarë dëshiron. Pra, kujdes me atë që dëshironi. Sepse ndryshe, mund t'iu ndodhë si atij djalit që zuri një ditë një peshk të artë në lum, i cili i kërkoi ta lironte në këmbim të realizimit të tri dëshirave. Dhe djali ishte i sigurtë se çfarë dëshirash kishte. Së pari, të ishte një princ, së dyti të zgjohej në mëngjes nga një princeshë e bukur dhe së treti, të udhëtonin së bashku në vende interesante dhe plot aventura. Dëshirat e tij u plotësuan. Të nesërmen ai u zgjua në një krevat princi, dera u hap nga një princeshë e bukur, e cila i tha: “Franc Ferdinand, erdhi koha të nisemi për në Sarajevë”.

** Fjala e Ivan Krastev mbajtur në konferencën vjetore të ambasadorëve shqiptarë, Ministria e Jashtme, 4 korrik 2014*



A kemi mbërritur në fundin e kombeve?

Deborah McKenzie

“Imagine there’s no countries... It isn’t hard to do” – “Imagjinoni të mos kishte shtete. Nuk është e vështirë” – këndonte John Lennon. Në fakt është e vështirë. Atëherë, si duhet të organizohemi? A është shteti komb një institucion i natyrshëm dhe i pashmangshëm? Apo është një anakronizëm i rrezikshëm në një botë të globalizuar?

Përpikuni për një moment të imagjinoni një botë pa shtete. Imagjinoni një hartë jo të ndarë në forma me ngjyra, secila me kufij të qartë, me qeveri, me ligje. Përpikuni të përshkruani çdo gjë që bën shoqëria jonë – tregti, udhëtime, shkencë, sport, ruajtje e paqes dhe siguri – pa përmendur shtetet. Përpikuni të përshkruani vetveten: ti ke të drejtën për të paktën një nënshtetësi, dhe të drejtën ta ndryshosh, por jo të drejtë të mos kesh fare.

Ato forma shumëngjyrëshe në hartë mund të jenë demokraci, diktatura, apo shumë kaotike për të qenë secila prej këtyre, por pothuajse të gjitha pretendojnë të jenë një gjë: një shtet komb, territori sovran i një “populli” apo kombi që kanë të drejtën e vetëvendosjes brenda një shteti të vetëqeverisur. Kështu thonë Kombet e Bashkuara, që tani numërojnë 193 të tillë.

Dhe gjithnjë e më shumë njerëz duan shtetin e tyre, që nga skocezët që votojnë për pavarësi, deri tek xhihadistët që shpallin një shtet të ri në Lindjen e Mesme. Shumë prej lajmeve më të mëdhenj sot, që nga konfliktet në Gazë dhe Ukrainë, deri tek grindjet për imigrimin dhe anëtarësimin në Bashkimin European, janë të lidhura në një farë mënyre me shtetet kombe.

Edhe në një kohë që ekonomitë tona globalizohen, shtetet kombe mbeten institucioni kryesor politik i planetit. Numri i madh i votave për partitë nacionaliste në zgjedhjet e këtij viti për BE-në provojnë se nacionalizmi mbetet gjallë – edhe nëse BE përpiket ta kapërcejë.

Megjithatë, ka një ndjesi në rritje mes ekonomistëve, politologëve dhe madje edhe qeverive kombëtare se shteti komb nuk është domosdoshmërisht shkalla më e mirë mbi të cilën të vijojmë punët tona. Ne mund të menaxhojmë çështjet jetike, si furnizimet me ushqime dhe klimën në një shkallë globale, megjithatë, agjendat kombëtare pengojnë në mënyrë të përsëritur të mirën globale. Në një shkallë më të vogël, administratat lokale dhe rajonale shpesh herë duket se u shërbejnë më mirë njerëzve, se sa qeveritë kombëtare.

Atëherë, si duhet të organizohemi? A është shteti komb një institucion i natyrshëm dhe i pashmangshëm? Apo është një anakronizëm i rrezikshëm në një botë të globalizuar?

Këto janë normalisht pyetje shkencore – por kjo po ndryshon. Teoricieët e kompleksitetit, shkencëtarët e shkencave sociale dhe historianët po i adresojnë me teknika të reja, dhe përgjigjet nuk janë gjithmonë ato që mund të priten. Nuk është aspak i pakohë fenomeni i kombit. Ai është i vonë. Dhe ndërkohë që kompleksiteti vjen në rritje, ai po pëson mutacion, pra shndërrim në struktura të reja politike. Bëhuni gati për neo-mesjetarizmin.

Përpara fundit të shekullit 18 nuk kishte shtete kombe të vërtetë, thotë John Breuilly i London School of Economics. Nëse udhëtoje nëpër Europë, askush nuk të kërkonte pasaportën në kufi; nuk ekzistonin as pasaporta dhe as kufij, ashtu si i njohim sot. Njerëzit kishin identitete etnikë dhe kulturorë, por këta nuk përcaktonin në të vërtetë entitetin politik ku ata jetonin.

Kjo shkon pas në kohë në antropologjinë dhe psikologjinë e politikës së hershme të njerëzimit. Ne e nisëm si familje të zgjeruara endacake, më pas formuam grupe të mëdhenj gjahtarësh, dhe më pas, afro 10 mijë vjet më parë, u vendosëm në fshatra fermerësh. Aleanca të tilla kishin avantazhe përshtatjeje, pasi njerëzit bashkëpunonin për t'u ushqyer dhe mbrojtur.

LUFTA DHE PAQJA

Por kishte edhe limite. Robin Dunbar, i Universitetit të Oxfordit ka treguar se një individ mund të ndjekë ndërveprimet sociale që lidhin jo më shumë se 150 vetë. Provat për këtë përfshijnë studime fshatrash dhe njësisht ushtarake gjatë gjithë historisë, si dhe numrin mesatar të miqve në Facebook.

Por kishte një arsye të rëndësishme për të patur më shumë shokë se aq: lufta. “Në shoqëritë e vogla, mes 10 deri 60 përqind të vdekjeve të meshkujve kanë si shkak luftën”, thotë Peter Turchin i Universitetit të Connecticutit në Storrs. Të kishe më shumë aleatë do të thoshte të kishe më shumë shanse për të mbijetuar.

Turchin ka zbuluar se perandoritë e lashta euraziatike u rritën atje ku luftimet ishin më të fortë, gjë që lë të kuptohet se lufta ishte një faktor madhor në zgjerimin politik. Arkeologu Ian Morris i Stanford University arsyeton se teksa popullsia rritej, njerëzit nuk mund të gjenin më toka të pazëna ku të mund t'u shpëtonin armiqve. Humbësit e betejave thjeshtë përthitheshin në zotërimet e armikut – kështu që këta zotërimet rriteshin edhe më shumë.

Si e kalonin numrin e Dunbarit? Përgjigja universale e njerëzimit

“
Përpara fundit të shekullit 18 nuk kishte shtete kombe të vërtetë, thotë John Breuilly i London School of Economics. Nëse udhëtoje nëpër Europë, askush nuk të kërkonte pasaportën në kufi; nuk ekzistonin as pasaporta dhe as kufij, ashtu si i njohim sot. Njerëzit kishin identitete etnikë dhe kulturorë, por këta nuk përcaktonin në të vërtetë entitetin politik ku ata jetonin. Kjo shkon pas në kohë në antropologjinë dhe psikologjinë e politikës së hershme të njerëzimit.”



ishite shpikja e hierarkisë. SHumë fshatra bënë aleancë mes tyre nën një kryetar; disa kryetarë u bashkuan nën një kryetar më të madh. Për t'u rritur, këto aleanca shtuan më shumë fshatra, dhe nëse ishte e nevojshme, më shumë shtresa hierarkie.

Hierarkitë nënkuptonin që udhëheqësit mund të koordinonin grupe të mëdhenj pa u dashur që dikush të merrej personalisht me 150 vetë. Përvec rrethit më të afërt, një individ ndërvepronte me një person të një niveli më të lartë në hierarki, dhe zakonisht me tetë vetë nga nivelet më të ulët, thotë Turchin.

Këto aleanca vazhduan të zgjerohen dhe të rriteshin në kompleksitet, me qëllim që të kryheshin aksione më kolektive, thotë Yaneer Bar-Yam e Institutit të Sistemeve Komplekse në Cambridge, Massachusetts. Që një shoqëri të mbijetojë, duhet që sjellja e saj kolektive të jetë po aq komplekse sa edhe sfidat me të cilat përballlet – duke përfshirë konkurrencën nga fqinjët. Nëse një grup përshtaste një shoqëri hierarkike, kështu duhej të bënin edhe fqinjët. Hierarkitë u përhapën dhe kompleksiteti social u rrit. Hierarkitë më të mëdha jo vetëm fituan më shumë luftëra, por edhe ushqenin më shumë njerëz përmes ekonomive të shkallës, që lejonin risi teknike dhe sociale si ujitja, depozitimi i ushqimit, mbajtja e rregjistrave dhe një fe bashkuese. Më pas, vijuan qytetet, mbretëritë dhe perandoritë.

Por këto nuk ishin shtete kombe. Një qytet apo rajon i pushtuar mund t'i nënshtrohet një perandorie pavarësisht identitetit “kombëtar” të banorëve. “Ideja e shtetit si një kuadër i domosdoshëm për politikën, mund të sfidohet kollaj”, thotë historiani Andreas Osiander i Universitetit të Leipzigit në Gjermani.

Një argument kryesor është se shoqëritë agrare kërkonin shumë pak qeverisje. Nëntë në dhjetë vetë ishin fshatarë që punonin në fermë, kështu që ishin kryesisht vetëorganizues. Qeveria ndërhyri për të marrë pjesën e saj, për të vendosur ligje bazë dhe për të ruajtur paqen brenda territoreve të padiskutuar. Përndryshe, roli i saj ishte të luftonte për të ruajtur ata territore, ose të pushtonte më shumë.

Edhe kohë më vonë, sundimtarët kalonin shumë pak kohë duke qeverisur, thotë Osiander. Në shekullin 17, Luigji XIV i Francës kishte gjysmë milioni trupa që luftonin në luftëra jashtë vendit por vetëm 2000 që ruanin rendin në vend. Në shekullin 18, holandezët dhe



zvicëranët nuk kishin nevojë për qeveri qendrore. Shumë imigrantë europiano lindorë që mbërrinin në SHBA në shekullin 19 mund të thonin se nga cili fshat vinin, por jo nga cili shtet: për ta, nuk kishte rëndësi.

Përpara epokës moderne, thotë Breuilly, njerëzit identifikoheshin “vertikalisht”, nga cilët ishin sundimtarët e tyre. Kishte shumë pak ndërveprim horizontal mes fshatarëve, përtej tregjeve lokale. Nuk kishte rëndësi se kush ishin të tjerët mbi të cilët sundonte mbreti.

Sisteme të tillë janë shumë të ndryshëm nga shtetet e sotëm, të cilët kanë kufij të mirëpërcaktuar të mbushur me nënshtetas. Perandoritë e lashta janë të ngjyrosura në hartat që shohim sot, sikur të kenë patur kufij të vendosur, por nuk ishte kështu. Përvec kësaj, njerëzit dhe territoret shpesh herë binin nën juridiksione të ndryshëm për qëllime të ndryshëm.

SHOQËRI TË THJESHTA

Një kontroll i tillë, jo i shtrënguar, thotë Bar-Yam, nënkuptonte që njësitë politike paramoderne ishin në gjendje vetëm për disa veprime të thjeshtë, si rritja e ushqimit, luftimi në betejë, mbledhja e haraçeve dhe ruajtja e rendit. Disa, si Perandoria Romake e bënë në një shkallë shumë të gjerë. Por kompleksiteti – veprimet e ndryshëm që shoqëria mund të kryente në mënyrë kolektive – ishte relativisht i ulët.

Kompleksiteti kufizohej nga energjia që një shoqëri mundej të tërhiqte. Për pjesën më të madhe të historisë, kjo ishte në thelb puna e njeriut dhe e kafshëve. Në fundin e Mesjetës, Europa shfrytëzonte më shumë, sidomos energji të ujit. Kjo e rriti kompleksitetin social – tregtia pësoi rritje, për shembull – duke kërkuar më shumë qeverisje. Një sistem feudal i decentralizuar i hapi rrugë monarkive të centralizuara me më shumë fuqi dhe pushtet.

Por këta nuk ishin ende shtete-kombe. Monarkitë përcaktoheshin nga ai që i sundonte, dhe rregullat përcaktoheshin me pranim të ndërsjellë – ose e kundërta e tij, lufta pothuaj e përhershme. Megjithatë, në Europë teksa tregtia sa vinte e rritej, monarkët zbuluan se mund të merrnin më shumë pushtet prej pasurisë, se sa prej luftërave.

Në vitin 1648, Paqja e Vestfalisë në Europë i dha fund disa shekujve luftë duke shpallur mbretëritë ekzistuese, perandoritë dhe njësi të tjera politike si “sovrane”: askush nuk duhej të ndërhynte në punët e brendshme të të tjerëve. Ky ishte një hap drejt shteteve moderne – por këta entitete sovranë ende nuk përcaktoheshin prej identiteteve kombëtare të popujve të tyre. thuhet se ligji ndërkombëtar e

ka origjinën në traktatin e Vestfalisë, megjithatë fjala “ndërkombëtar” nuk do të fillonte të përdorej deri 132 vjet më vonë.

Deri në atë moment, Europa kish mbërritur në pikën e kthesës të revolucionit industrial. Shfrytëzimi i më shumë energjie prej qymyrit nënkuptonte që sjelljet komplekse të individëve mund të amplifikoheshin, thotë Bar-Yam, duke prodhuar sjellje kolektive shumë më komplekse.

Kjo gjë kërkonte një lloj të ri qeverie. Në vitet 1776 dhe 1789, revolucionet në SHBA dhe në Francë krijuan të parët shtete-kombe, që përcaktoheshin prej identitetit kombëtar të nënshtetasve të tyre dhe jo prej prejardhjes së sundimtarëve. Sipas Breuilly, “në vitin 1800 pothuajse askush në Francë nuk e mendonte veten si francez. Në vitin 1900, të gjithë e mendonin veten si të tillë”. Për arsye të ndryshme, njerëzit në Angli kanë patur një ndjenjë të hershme të të qënurit “anglezë”, por kjo nuk ishte shprehur si një ideologji nacionaliste.

Deri në vitin 1918, me copëtimin e perandorive të fundit të mëdha shumëkombëshe të Europës, kufijtë shtetërorë europianë ishin ribërë kryesisht përgjatë vijave kulturore dhe gjuhësore. Të paktën në Europë, shteti-komb ishte normë.

Një pjesë e arsyes ishte një adaptim pragmatist i masës së kontrollit politik që kërkohej për të qeverisur një ekonomi industriale. Ndryshe nga bujqësia, industria ka nevojë për çelik, qymyr dhe burime të tjerë, të cilët nuk janë të shpërndarë në mënyrë uniforme, kështu që shumë mikro-shtete nuk ishin më të mundshëm. Ndërkohë, perandoritë u bënë gjithmonë e më të ngathëta teksa industrializoheshin dhe kishin nevojë për më shumë qeverisje reale. Kështu që, në Europën e shekullit 19, mikro-shtetet u shkrinë e u bashkuan ndërsa perandoritë u ndanë.

Këta shtete-kombe të rinj justifikoheshin jo thjeshtë si eficientë ekonomikisht, por si përmbushje e fatit kombëtar të banorëve të tyre. Një sërë historianësh kanë konkluduar megjithatë se kanë qenë shtetet që kanë përcaktuar kombet e tyre respektivë, dhe jo e kundërta.

Franca, për shembull, nuk ka qenë shprehja e natyrshme e një kombi francez që kish ekzistuar më herët. Në revolucionin e 1789, gjysma e banorëve të saj nuk flisnin frëngjisht. Në vitin 1860, kur u bashkua Italia, vetëm 2.5% e banorëve flisnin rregullisht italisht standarte. Udhëheqësit e saj i flisnin frëngjisht njëri-tjetrit. Njëri prej tyre madje tha atë shprehjen e famshme që, pasi kishin krijuar Italinë, tani duhej të krijonin italianët – një proces që shumëkush mendon se vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Sociologu Sinisha Malesheviç i Universitetit të Dublinit në Irlandë beson se ky “shtetndërtim” ka qenë një hap kyç në evolucionin e shteteve-kombe modernë. Ai kërkonte krijimin e një ideologjie nacionalizmi që e barazonte emocionalisht kombin me rrethin e familjes dhe miqve të njerëzve.

Kjo, nga ana tjetër, mbështetej fort në teknologjitë e komunikimit masiv. Në një analizë me shumë ndikim, Benedict Anderson i Cornell University në Nju Jork i përshkruante kombet si komunitete “të imagjinuar”: ata janë shumë më tepër se sa rrathët tanë më të afërt dhe ne nuk do i takojmë asnjëherë të gjithë, megjithatë njerëzit do të vdisnin për kombin e tyre ashtu si do të bënin për familjen.

Ndjenja të tilla nacionaliste, argumentonte ai, pasi librat në tregun masiv standartizuan gjuhën e folur dhe krijuan komunitete gjuhësorë. Gazetat mundësuan që njerëzit të mësonin për ngjarje me interes të përbashkët, duke krijuar një komunitet të madh “horizontal”, që më herët kish qenë i pamundur. Identiteti kombëtar u nxit qëllimisht edhe prej arsimit në masë të financuar prej shteteve.

Faktori kyç që vinte në lëvizje këtë proces ideologjik, thotë Malesheviç, ishte në fakt strukturor: zhvillimi i burokracive me shtrirje

“

Në vitet 1776 dhe 1789, revolucionet në SHBA dhe në Francë krijuan të parët shtete-kombe, që përcaktoheshin prej identitetit kombëtar të nënshtetasve të tyre dhe jo prej prejardhjes së sundimtarëve. Sipas Breuilly, “në vitin 1800 pothuajse askush në Francë nuk e mendonte veten si francez. Në vitin 1900, të gjithë e mendonin veten si të tillë”. Për arsye të ndryshme, njerëzit në Angli kanë patur një ndjenjë të hershme të të qënurit “anglezë”, por kjo nuk ishte shprehur si një ideologji nacionaliste

”

“
Pasi Europa
kishte krijuar
modelin e shtet-
tit-komb dhe ki-
shte përparuar,
thotë Breuilly, të
gjithë donin të
ndiqnin shem-
bullin e saj. Në
fakt, sot është
e vështirë të
mendosh që do
të mund të kish
patur ndonjë
rrugë tjetër.
Por a është një
strukturë që
u shfaq spon-
tanisht prej
kompleksitetit të
revolucionit in-
dustrial, mënyra
më e mirë për të
udhëhequr punët
tona?”

të gjerë që nevojiteshin për të qeverisur shoqëri shumë komplekse. Për shembull, thotë Breuilly, në vitet 1880 Prusia u bë qeveria e parë që bënte pagesa për papunësinë. Fillimisht këto paguheshin në fshatin e lindjes së një punëtori, ku identifikimi nuk ishte problem. Teksa njerëzit nisën të migrojnë për të gjetur punë, pagesat nisën të bëhen kudo në Prusi. “Pikërisht atëherë u duhej të përcaktonin se kush ishte një Prusian”, thotë ai, dhe për ta bërë kishin nevojë për burokracinë. Prej këtu erdhën dokumentat e nënshtetësisë, censuset dhe kufijtë e kontrolluar me policë.

Kjo solli një fryrje të strukturave të kontrollit, me më shumë shtresa të menaxhimit të mesëm. Pikërisht kjo burokraci ishte elementi që bashkoi njerëzit në njësi me madhësi kombesh, argumenton Malesheviç. Por jo me projekt: gjithçka erdhi e u zhvillua prej sjelljes së sistemeve hierarkikë kompleksë. Teksa njerëzit bëjnë gjithnjë e më shumë lloje aktivitete, thotë Bar-Yam, struktura e kontrollit e shoqërisë së tyre bëhet pashmangshmërisht më e dendur.

Në shtetin-komb, kjo përkthehet në më shumë burokratë për frymë. Të qënurit të lidhur pas një kontrolli kaq të fortë burokratik i nxiti njerëzit që të ndiejnë edhe lidhje personale me shtetin, si domos në një kohë kur lidhjet me kishën dhe fshatin erdhën duke u dobësuar. Teksa qeveria ushtronte gjithnjë e më shumë kontroll, njerëzit përftuan në këmbim më shumë të drejta, si ajo e votimit. Për herë të parë, njerëzit ndien se shteti ishte i tyre.

TANI DUHET TË FILLOJMË TË IMAGJINOJMË

Na pëlqen apo jo, shoqëritë tona ndoshta janë duke përjetuar këtë tranzicion. Por ende nuk mund të imagjinojmë që nuk ka më shtete. Por të pranojmë se ata ishin zgjidhje të përkohshme për situata historike specifike mundet që vetëm të na ndihmojë të menaxhojmë një tranzicion për çfarëdo që të kemi nevojë më pas. Strukturat me të cilat ne menaxhojmë punët tona po bëhen gati të ndryshojnë. Koha të fillojmë të imagjinojmë

Gjendje e natyrshme?

Pasi Europa kishte krijuar modelin e shtetit-komb dhe kishte përparuar, thotë Breuilly, të gjithë donin të ndiqnin shembullin e saj. Në fakt, sot është e vështirë të mendosh që do të mund të kish patur ndonjë rrugë tjetër. Por a është një strukturë që u shfaq spontanisht prej kompleksitetit të revolucionit industrial, mënyra më e mirë për të udhëhequr punët tona?

Sipas Brian Slattery i York University në Toronto, Kanada, shtetet-kombe vazhdojnë të lulëzojnë për shkak të një besimi të përhapur gjerësisht se “bota është natyrshëm e përbërë nga grupe homogjene kombëtarë apo fisnorë, të cilët zënë pjesë të ndryshme të globit, dhe pretendojnë përkatësinë parësore të shumicës së popujve”. Por kërkimet antropologjike nuk e konfirmojnë këtë, thotë ai. Edhe në shoqëritë fisnore, pluralizmi etnik dhe kulturor ka qenë gjithmonë i përhapur. Shumëgjuhësia është e zakonshme, kulturat shkrihen me njëra-tjetrën, dhe grupet gjuhësorë dhe kulturorë nuk janë të përpuhur.

Veç kësaj, njerëzit kanë gjithmonë një ndjesi që i përkasin grupeve të ndryshëm bazuar në rajonin, kulturën, prejardhjen dhe më shumë. “Pretendimi që identiteti dhe mirëqenia e një njeriu janë të lidhur në mënyrë qëndrore me mirëqenien e grupit kombëtar është i gabuar, thjeshtë duke u nisur edhe prej fakteve historike”, thotë Slattery.

Atëherë, ndoshta nuk ka pse habitemi që modeli i shtetit-komb dështon kaq shpesh: që nga vitet 1960 ka patur më shumë se 180 luftëra civile në gjithë botën.

Për konflikte të tillë, shpesh herë fajësohen tensionet etnikë ose sektarë. Shtetet e dështuar, si për shembull Siria sot, janë tipikisht të copëtuar prej dhunës përgjatë vijave të tilla. Sipas idesë që shtetet-



kombe duhet të përbëhen nga vetëm një komb, për këta dështime shpesh herë është fajësuar trashëgimia koloniale e bashkimit në një komb të disa popujve, brenda kufijve të panatyrshëm.

Por për çdo Siri apo Irak, ka një Singapor, Malajzi apo Tanzani, që shkojnë shumë mirë, pavarësisht se kanë shumë grupe “kombëtarë”. Ndërkohë, shtete imigrantë në Australi dhe në Amerika krijuan kombe unikë, në një diversitet fillestar shumë i madh.

Nga se vjen ky ndryshim? Ndërkohë që etnia dhe gjuha janë të rëndësishme, ajo që ka me të vërtetë rëndësi është burokracia. Kjo është e qartë në shumëllojshmërinë e fateve të shteteve të pavarur të Europës që u krijuan pasi perandoritë europiane u shpërbënë pas Luftës së Dytë Botërore.

Sipas mitologjisë së nacionalizmit, gjithë sa u nevojitej atyre ishte një territor, një flamur, një qeveri kombëtare dhe njohja nga OKB. Në fakt, ajo për të cilën kishin vërtetë nevojë ishte një burokraci komplekse.

Disa ish koloni që kishin një farë burokracie komplekse u shndërruan në demokraci, si për shembull India. Të tjera nuk u bënë, siç domos ato si ish Kongo belge, sundimtarët kolonialë të të cilave thjeshtë kishin marrë prej aty burimet natyrore. Shumë prej këtyre u shndërruan në diktatura, të cilat kërkojnë një burokraci shumë më të thjeshtë se sa demokracitë.

Diktaturat i acarojnë përplasjet etnike, sepse institucionet e tyre nuk nxisin identifikimin e qytetarëve me kombin. Në situata të tilla, njerëzit rendin drejt aleancave të besuara e që bazohen tek afërsia fa-



miljare, gjë e cila krijon shoqëri si e Dunbarit. Qeveri të pasigurta që bëjnë aleanca me grupe etnikë favorizojnë grupin e tyre etnik, ndërkohë që mes grupeve të tjerë rritet zemërimi – dhe konflikti që pason mund të jetë i ashpër.

Studime të kohëve të fundit konfirmojnë se problemi nuk është diversiteti etnik në vetvete, por një përfshirje e pamjaftueshme zyrtare. Vende që kanë pak diversitet etnik historik tani duhet ta mësojnë këtë rrugës, teksa njerëzit migrojnë për të gjetur punë në një ekonomi të globalizuar.

Rezultati i kësaj mund të varet nga mënyra si njerëzit vetë-segregohen. Njerëzve u pëlqen të kenë përreth njerëz si vetvetja, dhe rezultat i kësaj mund të jenë enklavat etnike. Jennifer Neal e Michigan State University ka përdorur modele për të zbuluar efektet e kësaj në fqinjësitë e qyteteve. Puna e saj sugjeron që enklavat promovojnë kohezionin social, por me koston e rënies së tolerancës mes grupeve. Zgjidhja mund të jetë enklava të vogla pranë e pranë mes tyre.

Por në çfarë shkalle? Bar-Yam thotë se komunitetet ku njerëzit janë të përzier mirë – si në Singaporin paqësor, ku enklavat shkurajohen aktivisht – kanë prirjen të mos kenë acarime etnikë. Enklavat më të mëdha mund të nxisin edhe stabilitetin. Duke përdorur modele matematikë për lidhjen e madhësisë së enklavave me shpeshtësinë e tensioneve etnikë në Indi, Zvicër dhe ish Jugosllavi, ai zbuloi se enklava 56 kilometra ose më shumë të gjera sjellin bashkëekzistencë paqësore – sidomos nëse janë të ndara prej barrierave të natyrshme gjeografike.

26 kantonet e Zvicrës, për shembull, që kanë gjuhë dhe besime të ndryshëm, e plotësojnë testin hapësinor të Bar-Yamit – përveç njërës.

Një enklavë frëngjisht-folëse në Bernën gjermanisht-folëse ka qenë e vetmja që ka përjetuar një trazirë të madhe në historinë e vonë të Zvicrës. U zgjidh duke e bërë një kanton të veçantë, Jura, që i përmbush kriteret.

Por, përsëri etnia dhe gjuha janë vetëm një pjesë e historisë. Lars-Erik Cederman i Institutit Federal Zviceran të Teknologjisë në Zyrih argumenton se kantonet zviceranë kanë arritur paqen jo përmes përshtatjes gjeografike të kufijve, por përmes marrëveshjeve politike që u kanë dhënë kantoneve autonomi të konsiderueshme si dhe një pjesë në vendimet kolektive.

Po kështu, duke përdorur një bazë të dhënash për të analizuar luftërat civile që nga viti 1960, Cederman zbulon se tensioni është në fakt më i mundshëm në vende me më shumë diversitet etnik. Por një analizë e kujdesshme konfirmon se problemet lindin jo vetëm nga diversiteti, por kur grupe të caktuar përjashtohen sistematikisht nga pushteti.

Qeveritë me politikë të bazuar mbi etninë kanë qenë veçanërisht të dobëta. SHBA krijoi pikërisht një qeveri të tillë në Irak pas pushtimit të vitit 2003. Përjashtimi i sunitëve nga shiitët bëri që kryengritësit të shpallnin një shtet sunit në territoret e pushtuar në Irak dhe në Siri. Duke i qëndruar mitologjisë së shtetit komb, ata refuzojnë kufijtë kolonialë të Irakut dhe Sirisë, teksa imponojnë “kombe” të ndryshëm që të bashkohen.

SPASTRIM ETNIK

Megjithatë, zgjidhja nuk mund të jetë imponimi i uniformitetit etnik. Historikisht, i ashtuquajtur i spastrim etnik ka qenë i përgjakshëm, dhe uniformiteti “kombëtar” nuk është garanci për harmoninë. Në çdo rast, nuk ka një definicion të mirë të një grupi etnik. Etnitë e shumë popujve janë të përziera dhe ndryshojnë me “motin” politik: numrat e atyre që pretendonin të ishin gjermanë në territorin e Sudetenland të aneksuar nga Hitleri ndryshoi dramatikisht përpara dhe pas luftës. Pretendimet e rusëve për rusisht-folësiht në Ukrainën lindore janë njësoj jobindës.

Edhe studimi i Bar-Yam, edhe ai i Cederman ofrojnë një përgjigje për diversitetin brenda shteteve-kombe: delegoja pushtetin komuniteteve lokale, siç kanë bërë shtete shumëkulturore si Belgjika dhe Kanadaja.

“Kemi nevojë për një konceptim të shtetit si një vend ku shoqërimet, gjuhët dhe fetë e shumta mund të jenë të sigurtë dhe të lulëzojnë”, thotë Slattey. “Ky është ideali që Tanzania ka përqafuar dhe duket se funksionon shumë mirë”. Tanzania ka më shumë se 120 grupe etnike dhe afro 100 gjuhë.

Në fund, ajo që mund të ketë më shumë rëndësi se sa etnia, gjuha apo feja, është ekonomia. Shkalla e nevojshme për prosperitetin mund të ketë ndryshuar me teknologjinë – Estonia e vogël është një fituese në drejtim të teknologjisë – por një shtet i vogël gjithësesi mund të mos ketë fuqi të mjaftueshme për të konkuruar.

Kjo është një arsye përse Estonia është një anëtar kaq entuziast i Bashkimit Europian. Pas luftërave shkatërrimtare në shekullin 20, vendet europiane u përpoqën të ndalojnë luftën e mëtejshme duke integruar industrinë e tyre bazë. Ky projekt, që më vonë u bë Bashkimi Europian, tani u ofron vendeve anëtarë pikësëpari ekonomi të shkallës, përmes prodhimit dhe më pas shitjes në tregun e përbashkët më të madh që ka bota.

Ajo që BE nuk arrin të frymëzojë është besnikëria e llojit nacionalist – që Malesheviç mendon se sot mbështetet mbi nacionalizmin “banal” të sportit, himneve, programeve televizive, madje edhe konkurset e muzikës. Kjo nënkupton që aleancat e europianëve nuk identifikohen më me njësinë politike që menaxhon pjesën më të

“
Qeveritë
me politikë të
bazuar mbi
etninë kanë qenë
veçanërisht të
dobëta. SHBA
krijoi pikëri-
sht një qeveri
të tillë në Irak
pas pushtimit
të vitit 2003.
Përjashtimi i
sunitëve nga
shiitët bëri që
kryengritësit
të shpallnin
një shtet sunit
në territoret
e pushtuar në
Irak dhe në Siri.
Duke i qëndruar
mitologjisë së
shtetit komb,
ata refuzojnë
kufijtë kolonialë
të Irakut dhe Si-
risë, teksa impo-
nojnë “kombe”
të ndryshëm që
të bashkohen.
”

madhe të qeverisjes së tyre.

Ironikisht, thotë Jan Zielonka i Universitetit të Oksfordit, BE ka shpëtuar shtetet-kombe të Europës, të cilët tani janë shumë të vegjë për të konkuruar individualisht. Thirrja nga partitë nacionaliste për “të rimarrë pushtetin nga Brukseli”, argumenton ai, do të çonte në vende më të dobët dhe jo më të fortë.

Ai sheh një problem të ndryshëm. Shtetet-kombe u rritën nga hierarkitë komplekse të revolucionit industrial. BE i shton një tjetër shtresë hierarkie – por pa një integrim të mjaftueshëm nën vete. Në fakt, i mungojnë të dy kushtet e nevojshëm të Malesheviçit: ideologjia nacionaliste dhe burokracia integruese.

Por edhe kështu, BE mund të tregojë rrugën drejt një bote të pas shteteve-kombe.

Zielonka bie dakord se integrimi i mëtejshëm i sistemeve qeverisës të Europës është i nevojshëm, teksa ekonomitë bëhen më të ndërvarura. Por ai thotë se hierarkia shpesh herë e paralizuar e Europës nuk mund ta arrijë këtë. Në vend të kësaj, ai sheh një zëvendësim të hierarkisë me një rrjet qytetesh, rajonesh e madje edhe organizatash joqeveritare. Ju tingëllon e njohur? Mbështetësit e quajnë neo-mesjetarizëm.

“Struktura e ardhshme dhe ushtrimi i pushtetit politik do i ngjajë modelit mesjetar më shumë se sa atij Vesfalian”, thotë Zielonka. “I dyti ka të bëjë me përqëndrimin e pushtetit, sovranitetin dhe identitetin e qartë”. Neo-mesjetarizmi, nga ana tjetër nënkupton autoritete të mbivendosur, sovranitet të ndarë, identitete dhe institucione qeverisës të shumtë, dhe kufij të paqartë.

Anne-Marie Slaughter e Princeton University, një ish ndihmës sekretare shteti, sheh gjithashtu që hierarkitë po i lënë vendin rrjeteve globale kryesisht të ekspertëve dhe burokratëve nga shtetet-kombe. Për shembull, qeveritë tani punojnë më shumë përmes rrjeteve fleksibël si G7 (ose 8, ose 20) për të menaxhuar problemet globale, se sa përmes hierarkisë së OKB-së.

Ian Goldin, kreu i Oxford Martin School në Universitetin e Oxfordit, që analizon problemet globale, mendon se duhet të dalin rrjete të tillë. Ai beson se institucionet ekzistues si agjencitë e OKB dhe Banka Botërore janë strukturalisht të paaftë të merren me problemet që shfaqen prej ndërlikohësisë globale, si paqëndrueshmëria ekonomike, sëmundjet, ndryshimi i klimës dhe siguria kibernetike – pjesërisht sepse ato janë hierarki të shteteve anëtarë që vetë nuk mundën të përballojnë këta probleme globale. Ai citon Slaughterin: “Problemet e rrjeteve kërkojnë një zgjidhje rrjetesh”.

Sërish, arsyen e shpjegojnë sistemet e sjelljes dhe limitet e trurit të njeriut. Bar-Yam thotë se në një hierarki, personi që është në krye duhet të jetë në gjendje të ketë në majë të gishtave të gjithë sistemin. Kur sistemet janë shumë komplekse për t’u rrokur nga një mendje njerëzore, ai argumenton se ata duhet të zhvillohen nga hierarkitë, në rrjete ku askush nuk është në krye.

Ku i lë kjo shtetet-kombe? “Ata mbeten mbajtësi kryesor i pushtetit në botë”, thotë Breuilly. Dhe ne na duhet fuqia e tyre për të ruajtur sigurinë personale që ka mundur rënien në pikën më të ulët të dhunës njerëzore.

Vec kësaj, thotë Dani Rodrik i Institutit të Princetone për Studime të Përparuara, vetë ekonomia e globalizuar që po lejon këta rrjete të zhvillohen ka nevojë për diçka apo dikë që të shkruajë dhe zbatojë rregullat. Shtetet-kombe janë aktualisht të vetmit entitete aq të fuqishëm sa ta bëjnë këtë gjë.

Megjithatë, limitet e tyre janë të qartë, si në zgjidhjen e problemeve globale, ashtu edhe në zgjidhjen e problemeve rajonale. I njohur si subsidiariteti, ky është një parim themelor i BE-së: ideja që qeveria

“*Struktura e ardhshme dhe ushtrimi i pushtetit politik do i ngjajë modelit mesjetar më shumë se sa atij Vesfalian*”, thotë Zielonka. “*I dyti ka të bëjë me përqëndrimin e pushtetit, sovranitetin dhe identitetin e qartë*”. Neo-mesjetarizmi, nga ana tjetër nënkupton autoritete të mbivendosur, sovranitet të ndarë, identitete dhe institucione qeverisës të shumtë, dhe kufij të paqartë.

duhet të veprojë në atë nivel ku është më efektive, me qeveri lokale për probleme lokale dhe fuqi më të larta në shkallë më të larta. Ka prova empirike që funksionon: sistemet sociale dhe ekologjike mund të qeverisen më mirë kur përdoruesit e tyre vetëorganizohen, se sa kur udhëhiqen nga liderë të jashtëm.


Megjithatë, është e vështirë të shohësh se si sistemi ynë politik mund të zhvillohet në mënyrë koherente në atë drejtim. Shtetet kombe mund të ecin në atë rrugë si përmes delegimit, ashtu edhe përmes rrjetëzimit për të arritur objektiva globale. Me ndryshimin e klimës, mund të argumentohet se e kanë bërë tashmë.

Ka një alternativë ndaj zhvillimit në një botë të globalizuar me rrjete të shumtë, neo-mesjetare apo jo, dhe kjo është kolapsi.

“Shumica e sistemeve hierarkike kanë prirjen të jenë të rëndë nga lart, të kushtueshëm dhe jo të aftë t’i përgjigjen ndryshimit”, thotë Marten Scheffer i Vaneningen University në Holandë. “Tensioni që rezulton mund të çlirohet përmes kolapsit të pjesshëm”. Për shtetet kombe, kjo mund të jetë gjithçka, që nga mbizotërimi i qyteteve, deri tek anarshia e stilit iraken. Një perspektivë e pasigurtë, por ka edhe një anë të mirë. Kolapsi, thonë disa, është shkatërrimi krijues që lejon daljen e strukturave të reja.

Na pëlqen apo jo, shoqëritë tona ndoshta janë duke përjetuar këtë tranzicion. Por ende nuk mund të imagjinojmë që nuk ka më shtete. Por të pranojmë se ata ishin zgjidhje të përkohshme për situata historike specifike mundet që vetëm të na ndihmojë të menaxhojmë një tranzicion për çfarëdo që të kemi nevojë më pas. Strukturat me të cilat ne menaxhojmë punët tona po bëhen gati të ndryshojnë. Koha të fillojmë të imagjinojmë.

NEW SCIENTIST





Një rikthim tek Kongresi i Vienës

DOMINIQUE MOISI

Një mbledhje e ekuivalentëve modernë të Metternichut, Castle-reaghut, Aleksandrit I dhe Talleyrandit është gjithashtu një ëndërr: nuk ka sot të tillë. Por, në konfrontimin e kaosit të sotëm dhe përshkallëzimin e dhunës, këta udhëheqës që kemi do të bënin mirë të gjenin pak frymëzim prej paraardhësve të tyre, të cilët 200 vjet më parë i hapën rrugën pothuajse një shekulli paqe

Dyqind vjet më parë, në 25 shtator 1814, Car Aleksandri I i Rusisë dhe Fridrih Vilhelmi III, Mbret i Prusisë, u përshëndetën tek portat e Vienës prej Perandorit të Austrisë, Franci I. Fillimi i Kongresit të Vienës i parapriu periudhës më të gjatë të paqes, që Europa kishte njohur prej shekujsh. Atëherë, përse është injoruar krejtësisht ky përvjetor?

Është e vërtetë që Kongresi i Vienës shihet kryesisht si momenti i fitores së forcave reaksionare të Europës, pas humbjes së Napoleonit. Megjithatë, duke parë konfuzionin global në rritje në kohët e sotme, në mos kaosin, nuk mundet të përjashtohet një farë “nostalgjie” prusiane për Kongresin.

“
Sigurisht, sot nuk mund të kemi ambicie rikrijimin e asaj bote (apo rivendosja e një rendi anakronik vestfalian të ndarjes fetare), por krijimi i një rendi të ri me supozime të rinj. Në të vërtetë, një prej elementëve kyç të kaosit aktual global është se, ndryshe nga Kongresi i Vienës – apo palët e 1648-ës – aktorët kryesorë të sistemit ndërkombëtar nuk janë të bashkuar prej një vullneti të përbashkët për mbrojtjen e statu quo-së
 ”

Ishte një takim që, përmes negociatave të vështira por të suksesshme, rivendosi rendin botëror pas trazirave që kishte shkaktuar Revolucioni francez dhe Luftërat Napoleonike. A mund të zbatohet sot ndonjërin prej mësimëve të tij?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të shohim jo vetëm Traktatin e Vienës të vitit 1815, por edhe Paqen e Vestfalisë të vitit 1648 dhe Traktatin e Versajës të vitit 1919, ku secili prej tyre, në mënyrën e vet, solli fundin e një kapitulli të përgjakshëm të historisë së Europës.

Marrëveshjet e firmosura në vitin 1648 përmbyllën pothuajse një shekull luftë duke mishëruar parimin e eius religio (e kujt është mbretëria, është edhe feja). Kongresi i Vienës rivendosi parimin e ekuilibrit të fuqive, bazuar mbi besimin se të gjithë palët ndanin një interes të përbashkët, duke kapërcyer ambiciet e tyre respektive, si dhe rivendosi KONcertin e Kombeve, që për dy breza ndali revizionizmat territorialë dhe ideologjikë, si ata që ishin parë nga 1789-a deri në 1815-ën. Ndërsa Traktati i Versajës, shumë i ashpër për t’u nderuar dhe shumë i dobët për t’u vënë në zbatim, shtroi rrugën për Luftën e Dytë Botërore.

Nga të tre këta traktate, ai që prodhoi Kongresi i Vienës ofron një lloj pasqyre për të na ndihmuar që të kuptojmë specifikën e gjendjes sonë aktuale. Në Vienë, fuqitë europiane ishin mes vetes. Ndjesia e tyre e përkatësisë në një familje të madhe dhe të bashkuar përforcohej prej origjinës së përbashkët aristokratike të diplomatëve të tyre. “Tjetri” kulturor nuk ishte problem.

Sigurisht, sot nuk mund të kemi ambicie rikrijimin e asaj bote (apo rivendosja e një rendi anakronik vestfalian të ndarjes fetare), por krijimi i një rendi të ri me supozime të rinj. Në të vërtetë, një prej elementëve kyç të kaosit aktual global është se, ndryshe nga Kongresi i Vienës – apo palët e 1648-ës – aktorët kryesorë të sistemit ndërkombëtar nuk janë të bashkuar prej një vullneti të përbashkët për mbrojtjen e statu quo-së.

Aktorët kryesorë ndahen në tre kategori: revizionistë të hapur, si Rusia dhe Shteti Islamik; ata që janë gati të luftojnë për të ruajtur një minimum rendi, si SHBA, Franca dhe Britania e Madhe; dhe shtete ambivalentë – duke përfshirë fuqitë rajonale kryesore në Lindjen e Mesme, si Turqia dhe Irani – veprimet e të cilëve nuk përputhen me retorikën e tyre.

Në një kontekst të tillë të përçarë, aleanca e “të moderuarve” e krijuar nga Presidenti Obama për të mposhtur Shtetin Islamik – një grup që përfshin Arabinë Saudite, Katarin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe – është në rastin më të mirë, e dobët. Një koalicion shumëkulturor është ndoshta një kërkesë për veprim legjitim ushtarak në Lindjen e Mesme; dilema është që, nëse koalicioni rajonal i Obamës nuk zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme, ky entuziasëm aktual i aleatëve për ndërhyrjen e SHBA me shumë gjasa do të zbehet shpejt.

One ndoshta diçka si “hegemonia bipolare” e Britanisë së Madhe dhe Rusisë pas 1815-ës (ndonëse aktorë të tjerë si Austria, Prusia dhe Franca kishin peshë) mund të rivendoset, me SHBA dhe Kinën që zëvendësojnë Britaninë e Madhe dhe Rusinë. Kjo duket të jetë ëndërra finale e Henry Kissingerit – një ëndërr që mund ta dallojmë në librin e tij më të fundit, me titull “Rendi Botëror: Refleksione për Karakterin e Kombeve dhe Kursin e Historisë”.

Por a mund të varemi ne prej realizimit të asaj ëndërr? Në një kohë kur përballemi me ekspansionizmin e Rusisë dhe ekstremizmin e banditëve mesianikë, mësimet nga Kongresi i Vienës mund të tingëllojnë të largët dhe pa lidhje. Megjithatë, njëri është i qartë: Shtetet kanë interesa të përbashkët që duhet të kalojnë prioritetet kombëtare.

Kina, India dhe Brazili janë palë me interesa në sistemin botëror, që do të thotë se edhe ato kanë nevojë për një minimum rendi. Por, kjo nënkupton që edhe ato duhet të kontribuojnë për ta ruajtur. Interesatve të Kinës, për shembull, do u shërbehej më mirë jo duke vënë Rusinë përballë SHBA, por duke zgjedhur palën pro rendit, kundër palës pro kaosit.



Një mbledhje e ekuivalentëve modernë të Metternichut, Castlereaghtut, Aleksandrit I dhe Talleyrandit është gjithashtu një ëndërr: nuk ka sot të tillë. Por, në konfrontimin e kaosit të sotëm dhe përshkallëzimin e dhunës, këta udhëheqës që kemi do të bënin mirë të gjenin pak frymëzim prej paraardhësve të tyre, të cilët 200 vjet më parë i hapën rrugën pothuajse një shekulli paqe. /Project Syndicate/



Kronikë e një rikthimi të paralajmëruar

OLIVIER FAYE

“Pas tridhjetë e pesë viteve mandate politike, angazhimi im në jetën e vendit tim, që sot e tutje do të jetë ndryshe”. Përpara qindra militantëve që thwrrisnin emrin e tij, Nicolas Sarkozy, më 6 maj 2012, në Mutualité (Organizëm i sigurimeve shoqërore në Francë), mbajti një fjalim të matur. Qysh në mbrëmjen e humbjes së tij në zgjedhjet presidenciale, ish-presidenti kujdeset në daljet e tij për të menaxhuar shanset e kthimit. Më 19 shtator, ai e theu këtë angazhim duke u vetwshpallur kandidat në kryesinë e UMP. Të nesërmen e dështimit të tij, rrethi i tij i ngushtë përsëriste megjithatë dëshirën që ai kishte qëllim të qëndronte “i larguar në mënyrë të qëndrueshme” nga politika.

Por Nicolas Sarkozy nuk ka qëndruar për një kohë të gjatë larg ... Vetëm tre muaj pas largimit të tij nga Elysée, në mes të verës, ai doli nga qetësia dhe kërkoi më 8 gusht 2012, “një veprim të shpejtë të komunitetit ndërkombëtar” në Siri, me qëllim që të “të evitohen masakrat”.

Një kritikë e hapur e politikës të ndjekur për këtë dosje nga François Hollande.

Ai i cili kishte siguruar se do ndërpriste politikën në rast humbje në zgjedhjet presidenciale, paraqitet menjëherë si kryetar i opozitës dhe si kryetar i shtetit njëkohësisht.

“
Para së gjithash, ai është i shqetësuar për situatën e vendit dhe do të zbresë në arenë vetëm për detyrë”, përsërisin ata. Këtë do ta shprehte ai vetë në mars të vitit 2013, në bashkëbisedimin e parë dhënë shtypit pas humbjes: “Fatkeqësisht do të ketë një çast ku çështja nuk do të jetë më: A keni ju dëshirë?, por : “A do të keni ju zgjedhje?” (...). Në këtë rast, efektivisht, unë do të jem i detyruar të bëjë një hap përpara. Jo për dëshirë. Por për detyrë
 ”

Si në krahun e majtë dhe në atë të djathtë, secili e ka kuptuar mesazhin: Nicolas Sarkozy dëshiron të mbesë në peisazhin, në optikën e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2017. Në vjeshtë, partia e djathtë duhet të zgjedhë një kryetar të ri. Ish presidenti ka vetëm një obsesion: të pengojë zgjedhjen në krye të UMP të një personaliteti në gjëndje ta zëvendësojë atë në zemër të simpatizantëve. François Fillon është më mirë i pozicionuar për të marrë leadershipin. Ai u largua shpejt nga Sarkozy, të cilit i atribuon të metat në qeverisje gjatë pesë vjetëve. Sondazhet e nxjerrin ish-kryeministrin fitues me më shumë se 60 % të votave. Për sarkozystët nuk bëhet fjalë që të lejnë deputetin e Parisit që të fitojë përballë Jean-François Copé.

Në kulisa, Sarkozy aktivizohet për të penguar një skenar të tillë. Pasi nxiti rritjen e kandidaturave, ai lidh një aleancë strategjike me kryetarin e bashkisë të Seine-et-Marne. Operacioni sjell frytet e tij, përtej asaj që ai kishte mundur të imagjinonte: dueli Copé- Fillon përfundon me një barazim nga të gjitha pikëpamjet. Mbrëmjen e 18 nëntorit, i pari tenton një puç që i dyti e kundërshton. Partia shfaqet e ndarë drejtpërdrejt në televizion.

Duke akuzuar njëri-tjetrin për mashtrim, të dy palët ndërloftuese shfaqen si shefa klanesh. Psikodrama zgjat më tepër se katër javë. Ajo çoi në një amnisti të çalë, në fund të vitit 2012, duke e bërë Jean-François Copé një kryetar shumë të kontestuar. Nicolas Sarkozy, me një goditje të dyfishtë arriti me sukses të bllokonte forcimin e Fillon, si dhe duke e detyruar deputetin e Seine-et-Marne ta vendoste në tutelën e tij.

Ish presidenti arrin madje të legjitimojë a posteriori vijën e fushatës së tij, e frymëzuar nga Patrick Buisson, këshilltari i tij i ardhur nga ekstremi i djathtë, duke nxitur në gjithë UMP fitoren e të rinjve sarkozistë të së djathtës së fortë, të cilët formojnë sot rrymën e parë të partisë. Kjo fiasko e ndan në mënyrë të qëndrueshme të djathtën. Dy vite më pas ajo është ende në origjinë të krizës së leadershipit, e kaluar nga partia, dhe lejon Nicolas Sarkozynë të shfaqet si “shpëtimtari” i familjes së tij politike.

Ish presidenti e din gjithashtu se francezët nuk duan aq shumë pensionistët e politikës. Të urryer në pushtet, drejtuesit publikë shihen me dashamirësi sapo ata bëjnë një hap jashtë skenës.

Për Nicolas Sarkozynë, është mirë pra që të qëndrojë i tërhequr, duke i ofruar bashkëkombësve të tij herë pas here kujtimet e mira. Sekuenca e “kartolinave” hapet për pensionistin më aktiv të Francës.

Natën e 6 majit, ai është vetë i detyruar të heshtë. Njerëzit e tij me në krye Brice Hortefeux, ngarkohen që të përcjellin mesazhet. Ata sigurojnë që Nicolas Sarkozy nuk dëshiron të rikthehet për të marrë revanshin e tij mbi François Hollande.

“Para së gjithash, ai është i shqetësuar për situatën e vendit dhe do të zbresë në arenë vetëm për detyrë”, përsërisin ata. Këtë do ta shprehte ai vetë në mars të vitit 2013, në bashkëbisedimin e parë dhënë shtypit pas humbjes: “Fatkeqësisht do të ketë një çast ku çështja nuk do të jetë më: A keni ju dëshirë?, por : “A do të keni ju zgjedhje?” (...) Në këtë rast, efektivisht, unë do të jem i detyruar të bëjë një hap përpara. Jo për dëshirë. Por për detyrë”. Refreni i kthimit “për detyrë” do të këndohet pa pushim në muajt që vijnë. Në biseda private, Sarkozy ka fjalë mjaft të ashpra për François Hollande, duke e cilësuar një “nul”.

“Ish-i” qëndron në realitet “i lidhur” me jetën publike të vendit që ai e ka drejtuar gjatë pesë viteve. Në zyrat e tij nr.77, në rrugën “Miromesnil” në Paris parakalojnë personalitete të huaja, sportistë, drejtues ndërmarrjesh, pronarë të shtypit dhe sidomos shumë politikanë.

Shumë persona janë të bindur se ai do të përfaqësohet në zgjedhjet presidenciale në vitin 2017. “Është një luan në një kafaz. Ai ka kaq dëshirë që të skuqet, që t’i shohin kur nxjerr këmbët!”, shprehet me shaka një vizitor.

“Kjo është sikur t’i kërkoje një mishngrënësi të bëhej vegjetarian”, buzëqesh Brice Hortefeux. Më 8 korrik të vitit 2013, historia shpejtohet: ish-kryetari i shtetit nënshkruan kthimin e tij në UMP nën syrin e kame-

//

Presidenti Obama ka thënë vazhdimisht se nuk duhet ta vrasim mendjen për sigurinë e të tjerëve, më shumë se sa ata vetë. Kjo është një ide e keqinterpretuar e shoqërive në rrezik. Sigurisht që ata shqetësohen më shumë se sa ne për sigurinë e tyre

//

rave, që ndjekin mbwritjen e tij si të një rock star-i. Në sajë të një operacioni komunikimi të orkestruar me mençuri, ai arrin të bëjë që të harrohet mbledhja e Këshillit kushtetues për krizën, e shkaktuar për shpenzimet e bëra gjatë fushatës presidenciale të vitit 2012.

Përballë më tepër se 300 parlamentarëve të UMP-së, të mbledhur në sallën e madhe të mbledhjeve të partisë, Nicolas Sarkozy i zhvleftëson rivalët e tij – François Fillon në veçanti – për t'i thënë atyre, në thelb: “Padroni jam unë!”. Ai shpjegon se ka vendosur të “thyejë” vendimin e tij “për t’u tërhequr nga jeta politike” dhe me një ton provokues shprehet se të gjithë ato që duan ta varrosin atë: “Ditën kur unë do të kthehem, do t’ju paralajmëroj”. Vizita të tjera në terren të ish presidentit do të vijojnë, me objektivin për t’i treguar rivalëve të tij që tërheqja për të mbetet e paprekur pranë bazës militante.

Më 18 shtator, një turmë e madhe e pret Sarkozynë gjatë një vizite në rajonin e Haute-Savoie dhe aty përmend për herë të parë një kalendar kthimi. Dhe nëntë ditë më vonë, ish presidenti shafqet në qytetin e Nicës, i rrethuar nga militantët në ekstazë.

Në nëntor të vitit 2013, ai nis një fushatë jo zyrtare duke ndjekur koncertet e gruas së tij në qytetet ku ka fituar e djathta. Dyshimet e fundit mbi qëllimet e “Ish-it” eklipsohen në janar 2014, gjatë një vizite në Châtelailon, në Charente-Maritime: “Kur ke qenë president, mbetesh i tillë”, do të shprehej ai. Ish kryetari i shtetit mbetet shumë popullor pranë zgjedhësve të djathtë. Me përjashtim të Xavier Bertrand, i cili ka hartuar një strategji politike, dhe të François Fillon, me ndërprerje, të rrallë janë ata që rrezikojnë ta kritikojnë atë.

Bruno Le Maire (ish ministër i Bujqësisë) dhe sidomos Alain Juppé (ish ministër i jashtëm), bëjnë kujdes të mos e sulmojnë pensionistin e vërtetë e fals. Në një takim me kandidaten për Bashkinë e Parisit, Nathalie Kosciusko-Morizet në Paris në muajin shkurt të këtij viti, disa javë para zgjedhjeve lokale, Sarkozy pritet me nostalgji nga militantët e partisë. Ai e eklipson kandidaten e djathtë për Bashkimë e Parisit.

Ky takim i lejon të shfaqet me gardën e re të UMP-së dhe të tregojë vullnetin e tij për të ripërtërirë rrethin e tij të ngushtë. Nuk ka rëndësi që kthimi i programuar mund të hidhet poshtë nga dy të tretat e francezëve, sipas sondazheve. “Të flitet për kthimin tim në jetën politike, kjo në vetvehtë është diçka e mrekullueshme”, shprehet i gëzuar Nicolas Sarkozy në emisionin ekonomik televiziv të titulluar “Vlerat aktuale”, në korrik të vitit 2014.

Kjo don të thotë se ideja e kthimit është regjistruar në zemrat dhe në mendjet. Duke filluar nga ky çast, një pjesë e madhe e rrugës është bërë.

Emri i tij është cituar në shumë dosje : në atë të arbitrazhit të Bernard Tapie, të sondazheve të Elysée, afera Karachi apo edhe financimi i supozuar libian i fushatës së tij presidenciale në vitin 2007.

Pa përmendur regjistrimet e fshehta të Patrick Buisson apo llogaritë e dyshimta Bygmalion. Kjo dosje e fundit është ajo që e dëmton atë më tepër për imazhin e tij pranë të zgjedhurve dhe zgjedhësve të UMP, të cilët kanë marrë pjesë financiarisht në “Sarkothon” dhe ndjehen të “vjedhur”. Situata bëhet kritike. Në rënie në sondazhet, i ngacmuar nga kundërshtarët e tij, Sarkozy e din që mund të humbasë gjithcka.

Për të ruajtur shanset e tij të kthimit, ai kundërsulmon me një strategji të thjeshtë: të paraqitet si viktimë, me qëllim që të ndjellë rreth vetes një refleks solidariteti të bazës së UMP-së. Në një artikull në gazetën “Figaro” në mars 2014, pastaj gjatë një bashkëbisedimi në kanalin televiziv TF1 dhe Europe 1, më 2 korrik, ai paraqitet si një kafshë që e ndjekin, viktimë e tërbimit të gjykatësve dhe pushtetit socialist, që duan ta “vrasin” atë. Besnikët e tij në mënyrë masive e përhapin këtë mesazh. Strategjia e viktimizimit nuk shkon në të gjithë opinionin francez, por funksionon pranë militantëve të UMP, të cilët thërrasin për komplot.



Ky është kapitali më i çmuar përballë Alain Juppé apo François Fillon në garën drejt Elysée-se. Një elektorat strategjik që përfaqson ende sot shansin kryesor, në çastin për t'u hedhur drejt pushtimit të UMP-se.
/Le Monde/



Kohë e dyshimeve dhe paqartësive

FREDERIC LEMAITRE

Ka pak të ngjarë që tridhjetë e tre orët që Manuel Valls do të kalojë në Gjermani, më 22 dhe 23 shtator, mjaftojnë të mbyllin keqkuptimet midis dy vendeve. E parë nga Parisi, përpjekja është e madhe për të kundërshtuar në Berlin konservatorët – Angela Merkelin dhe ministrin e saj të financave Wolfgang Schäuble, i papërkulshëm në ortodoksinë buxhetore – dhe social-demokratët, sidomos Sigmar Gabrielin, presidentin e SPD dhe ministër i ekonomisë, të cilët do të pranonin të jepnin prova fleksibiliteti në interpretimin e paktit të stabilitetit dhe të rritjes ekonomike dhe do të ishin në favor për një rritje të konsumit në Gjermani.

SITUATA ËSHTË MË KOMPLEKSE

Po, ka një debat ekonomik në Gjermani mbi nevojën ose jo për të nxitur investimet, sidomos në infrastrukturë. Disa ekonomistë, sindikatat, por gjithashtu ndërmarrjet e lidhura me sektorët e interesuar kërkojnë një politikë të tillë. I vetmi problem: nëse SPD dhe CDU janë në favor, ato dëshirojnë që sektori privat të marrë në ngarkim të tij pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve. SPD, e aq më tepër CDU, nuk e vënë në diskutim ekuilibrin buxhetor të parashikuar për vitin 2015 dhe vitet në vijim.

“
**Një dështim ekonomik i Hol-
lande, i ndjekur nga një dështim i kandidatit socia-
list në zgjedhjet presidenciale të pranverës së vitit 2017, mund vetëm të dëmtojnë imazhin e SPD, disa muaj para zgjedhjeve gjermane, të parashikuara të mbahen në vjeshtën e vitit 2017. Shenjë e shqetësimit të SPD: të nesërmen e vizitës së Valls në Berlin, Fondacioni Friedrich-Ebert (i krijuar në vitin 1925), shumë i afërt me social-demokratët gjermanë organizon një kolokium për Francën në Berlin**
”

Ka mundësi që, një ditë të dy partitë të ndjejnë keqardhje që kanë vendosur në Kushtetutë ekuilibrin e shpenzimeve publike. Por ky debat nuk bëhet sot as nga CDU, as dhe nga SPD, e cila përpiket të joshë klasat e mesme për të tërhequr më tepër se një zgjedhës në katër në zgjedhjet e ardhshme në Gjermani.

Ndryshim thelbësor me Francën: të gjitha partitë politike gjykojnë se rënia demografike e vendit detyron Gjermaninë të pakësojë borxhin e saj në vitet që vijnë, sepse barra rrezikon të jetë shumë e rëndë për brezat e ardhshëm.

Ndryshimet e opinioneve midis CDU dhe SPD janë pra më të vogla se sa i mendon ato qeveria franceze. Gjithashtu, përtej fjalimeve zyrtare, të dy partitë kanë të njëjtat dyshime mbi reformat e bëra nga François Hollande dhe Kryeministri, Manuel Valls. SPD kujton se në pjesën më të madhe janë Jacques Chirac dhe Nicolas Sarkozy të cilët e vunë Francën në gjëndjen ku ajo është sot, por social-demokratët janë po aq të shqetësuar sa CDU për situatën ekonomike franceze. Ndofta edhe më shumë.

Një dështim ekonomik i Hollande, i ndjekur nga një dështim i kandidatit socialist në zgjedhjet presidenciale të pranverës së vitit 2017, mund vetëm të dëmtojnë imazhin e SPD, disa muaj para zgjedhjeve gjermane, të parashikuara të mbahen në vjeshtën e vitit 2017. Shenjë e shqetësimit të SPD: të nesërmen e vizitës së Valls në Berlin, Fondacioni Friedrich-Ebert (i krijuar në vitin 1925), shumë i afërt me social-demokratët gjermanë organizon një kolokium për Francën në Berlin. “Franca gjithnjë e më tepër përballet jo vetëm në terrenin politik, por dhe në planin ekonomik me një konkurrencë të re të Spanjës dhe Portugalisë. Çfarë pasojash kanë reformat dhe ulja e shpërblimeve në këto dy vende, mbi strukturat ekonomike dhe sociale të Francës? Çfarë pasojash mbi ekuilibrin në gjirin e zonës euro? Dhe çfarë politike ekonomike mundet dhe duhet të bëjë Franca?”, pyesin organizatorët.

UNIVERSE GJITHNJË E MË TEPËR TË DISTANCUARA

SPD bën saktësisht të njëjtën analizë si CDU. Spanja dhe Portugalia po reformohen, Franca jo, e kjo e bën më pak konkurese. Për të gjallëruar këtë debat, fondacioni i ka bërë thirrje Andreas Schockenhoffit, një deputet kristian-demokrat shumë kritik për qeverinë e Hollande. Pra Kryeministri Valls të mos ketë asnjë iluzion. Gabriel nuk është më shumë i bindur se sa kancelarja Merkel që Franca po bën reforma strukturore, që do t’i lejojnë asaj të bëhet përsëri konkurese. I vetmi ndryshim me kancelaren: SPD pranon se në Gjermani, reformat sociale i kanë i kanë paraprirë ringritjes së llogarive. Por për gjermanët Franca fatkeqësisht nuk ka zgjedhje. Është për të ardhur keq që kryeministri francez, i cili ka folur sot përpara pro-narëve gjermanë gjatë “ditës së industrisë gjermane”, nuk mund të asistojë në të gjithë debatet. Ai do shikojë që industrialistët francezë dhe gjermanë jetojnë në universe gjithnjë e më tepër të distancuara. Të parët ankohen për koston e punës dhe për 35 orët, të dytët kanë në gojë vetëm një fjalë: “industria 4.0”. Revolucioni i katërt industrial, i cili qëndron në bashkimin e Internetit dhe industrisë tradicionale, si në produktin përfundimtar ashtu dhe në procesin e prodhimit, është obsesion i tyre.

Është ky revolucion që do t’i lejojë gjermanët të jenë në avancë në raport me konkurentët e tyre, sidomos ata aziatikë. Por problem është fakti që teknologjitë e informacionit janë amerikane. Ata kanë frikë pra që nesër Google dhe Apple të marrin pushtetin tek Volkswagen dhe BMW. Nuk është një rastësi që kancelarja Merkel i kërkoi Jean-Claude Junckerit që një gjerman, Günther Oettinger, të jetë komisar i ardhshëm për ekonominë digjitale.

Për Francën, ky post është sekondar. Për Gjermaninë ai është strategjik.



Ndërkohë që nga viti 2010 deri në vitin 2012, pjesa e kërkimit shkencor dhe e zhvillimit në GDP mbeti pothuaj e qëndrueshme në Francë (nga 2,24 % deri në 2,26 %, sipas Bankës Botërore), Gjermania megjithë masat shtrënguese, për buxhetin e shkencës parashikon të jetë nga 2,8 % në 2,9 % të GDP-së. /Le Monde/



Skocia, një leksion demokracie

JOHN LLOYD

Thuhet se një ditë, dikush pyeti shkrimtarin irlandez, Samuel Beckett nëse ishte anglez, dhe Beckett iu përgjigj: “Jo, madje jam kundër”. Një irlandez si ai mund ta ketë thënë vërtetë. Normale në atë kohë, mbi të gjitha në fillimet e shekullit XX, kur revolucioni kundër Britanisë së Madhe i dha jetë një shteti të veçuar, mosbesues prej dekadash, ndaj Britanisë së Madhe. Normale që pikërisht në atë epokë, një irlandez ka qenë më shumë se kurrë “kundër” një anglezi. Skocezët dëgjuan t’u thuhet prej nacionalistëve se edhe ata duhet të jenë “kundër” anglezëve, por dje vendosën që nuk është kështu. Referendumi për pavarësinë ka qenë një leksion i bukur demokracie, argument për të cilin britanikët janë mbathur prej kohësh. Gjatë dekadave të ndryshme, Partia Nacionale Skoceze ka arritur të mbledhë përreth vetes një elektorat gjithnjë e më të shumtë që e mbështet, si ide të pavarësisë. Partia ka fituar shumicën e vendeve në parlamentin skocez, dhe qeveris në mënyrë eficiente.

Pas fitores në parlament, partia kërkoi zhvillimin e një referendumi për pavarësinë. David Cameron, kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar ka pranuar, duke pranuar edhe që pyetja në referendum të formulohej në këtë mënyrë: “A duhet të jetë Skocia një shtet i pavarur?” Për më tepër: ka pra-

“
**Fushata
 ishte civile
 dhe shumë
 demokratike,
 domethënë ka
 zgjuar një vend
 që rrallëherë
 ka një prani
 në kutitë e
 votimit mbi
 65%, ndërkohë
 që këtë herë
 ka qenë 85%;
 dhe ka hapur
 një debat që
 ka depërtuar
 kudo. Ka
 ndodhur edhe
 në Angli. Të
 flasësh me
 theks skocez
 do të thotë
 të ftosh të
 flasësh për
 Kushtetutën e
 vendit, zakoni-
 sht në mënyrë
 të sjellshme,
 ndonjëherë me
 skepticizëm,
 rrallëherë me
 armiqësi**
 ”

nuar që skocezët që nuk banojnë në Skoci, të mos kishin të drejtën e votës. Cfarë zhgënjimi për ne, 700 mijë banorë të Anglisë që e quajmë veten ende skocezë (përveçse britanikë), megjithatë e praniam.

Fushata ishte civile dhe shumë demokratike, domethënë ka zgjuar një vend që rrallëherë ka një prani në kutitë e votimit mbi 65%, ndërkohë që këtë herë ka qenë 85%; dhe ka hapur një debat që ka depërtuar kudo. Ka ndodhur edhe në Angli. Të flasësh me theks skocez do të thotë të ftosh të flasësh për Kushtetutën e vendit, zakonisht në mënyrë të sjellshme, ndonjëherë me skepticizëm, rrallëherë me armiqësi.

Ndonjë episod të vogël dhune në Skoci ka patur, me sa duket mbi të gjitha prej mbështetësve të “PO”-së, në tentativën për të bërë të heshtin oratorët e “JO”-së, dhe në dy raste duke detyruar udhëheqësin laburist, Ed Miliband që të heqë dorë nga diskutimi i tij. Disa mbështetës të pavarësisë janë ndier të kërcënuar, gjë që mund të shpjegojë hendekun mes sondazheve të opinionit dhe rezultatit real: “ shumica e heshtur ” me sa duket është shprehur me sinjeritet vetëm brenda dhomës së votimit. Mëkat. Megjithatë, jemi shumë larg prej Këmishave të Zeza të Berlinit 1933.

Megjithatë, ka edhe një tjetër leksion që mund të nxirret nga referendumi, shumë më pak i pëlqyer për europianët: pavarësisht humbjes së nacionalistëve, vetë fakti që referendumi u zhvillua, që qeveria kombëtare e organizoi dhe që qeveria rajonale e zhvilloi në mënyrë të përgjegjshme, përbën një shembuj për nacionalistët e vendeve të tjerë. Kryeministri spanjoll, Mariano Rajoy nuk do të gëzohet prej referendumit në Skoci, duke parë që Katalonja dëshiron të bëjë të njëjtën gjë. Një shembull qeverisjeje demokratike, që atij i është kërkuar ta lartësojë.

Por nuk bëhet fjalë vetëm për nacionalizëm: Alex Salmond, ministri i parë i Skocisë, ka parashtruar për skocezët vizionin e një vendi të pavarur, të pasur falë vendburimeve të naftës në Detin e Veriut, në gjendje të ndërtojë një socialdemokraci të stilit skandinav. Salmond e ka bërë duke vënë në shënjestër Parlamentin e Uestminsterit me të gjithë partitë kombëtare, e sidomos qeverinë e koalicionit të Mbretërisë së Bashkuar të udhëhequr nga konservatorët – në “mëshirën” e ortodoksisë “neoliberale” dhe masave qesharake të kursimit, prej të cilave një Skoci e pavarur do të kishte shpëtuar lehtësisht. Në krahasim me zona të tjera të Europës, në të vërtetë masat e shtrëngimit janë më të vogla në Mbretërinë e Bashkuar, dhe rritja e GDP vitin që kaloi ka qenë më e larta, me një rënie të papunësisë, mbi të gjitha mes të rinjve.

Megjithatë, është e vërtetë që ka patur shkurtme të konsiderueshëm në shpenzimet sociale, buxhetet e autoriteteve lokale dhe Mbrojtjen. Si gjithmonë, ajo që ka vuajtur më shumë nga shkurtimet buxhetore ka qenë shtesa më e varfër e popullsisë, dhe për këtë arsye zemërimi dhe dëshpërimi, të dy realë, janë të fortë dhe ndikojnë negativisht mbi popullaritetin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Kryeministrit Cameron.

Skocia e ka çduar drejt pasojave ekstreme këtë mungesë popullariteti, e megjithatë ajo nuk e ka monopolin për të qenë zëdhënëse. Në këtë pikë duhet rimarrë pyetja e formuluar në kohën e tij nga Peter Mair, studiues në Universitetin evropian të Firences, në librin: “Të qeverisësh boshllëkun”: si mund të qeverisësh “me përgjegjshmëri”, duke kënaqur nevojat e elektoratit dhe në të njëjtën kohë të mbash inflacionin dhe borxhin në nivele të ulët, duke kufizuar shpenzimet publike, shkurtuar burokracinë? Kjo është një sfidë që çdo qeveri duhet ta ndeshë kudo: por është një sfidë sidomos e theksuar në Europë, dhe Rusia e ka bërë edhe më të dukshme në nivel zyrtar.

Në fund, Skocia ka tërhequr vëmendjen për asimetrinë e Mbretërisë së Bashkuar, në brendësi të të cilës Anglia zë 85% të popullsisë, ndërkohë që palët e tjera – Irlanda e Veriut, Skocia dhe Uellsit – kanë të gjitha dimensionet shumë më të vegjël por kanë të gjitha parlamentet e tyre. Vetëm anglezët nuk kanë. Menjëherë pas marrjes së rezultatit të referendumit, në televizionet britanikë janë shfaqur shumë politikanë anglezë që janë ankuar



për faktin që Skocia trajtohet me vlerësim të veçantë, ndërkohë që nuk ekziston i njëjti vlerësim në trajtimin e Anglisë. Presioni për një parlament anglez me siguri do të rritet.

Do të jetë e vështirë, shumë e vështirë, të mbërrihet në një union si ai i SHBA, Gjermanisë, Italisë, vende ku rajone apo shtete të fortë jetojnë në mënyrë pak a shumë të rehatshme në brendësi të një strukture kombëtare. Fortësia në dukje e Mbretërisë së Bashkuar ka fshehur në fakt një strukturë kushtetuese tre shekullore që është vjetëruar dhe që tani duhet ndryshuar. Nga ky pikëvështrim, Skocia dhe e gjithë Mbretëria e Bashkuar duhet të shikojë përtej kufijve të saj dhe të gjejë shembuj të vlefshëm gjetkë, duke u sforcuar t'i japë jetë një unioni që të plotësojë kërkesat e barazisë në trajtim, të cilat me siguri nuk do të zhduken.



Një Komision shumë “politik”

JEAN-PIERRE STROOBANTS

Në përfundim të një vere intensive bisedimesh, luksemburgasi Jean-Claude Juncker, i cili do të zëvendësojë José Manuel Barroson në krye të Komisionit Evropian në 1 nëntor, paraqiti të mërkurën “kolegjin” e tij me 26 komisionerë.

Një për shtet anëtar, pa Luksemburgun (tashmë me postin që ai mban), dhe Italinë, pasi Federica Mogherini në fund të gushtit u caktua përfaqësuesja e lartë për politikën e jashtme, dhe në të njëjtën kohë zëvendës-presidente e Komisionit.

Ekipi i Junckerit ka punuar fort për të përmbushur prioritetet e tij, ekuilibret politike dhe gjeografike evropiane, si dhe një paritet relativ meshkuj-femra. “U panë 54 versione të organigramës, deri në çastet e fundit”, sipas një burimi në Parlamentin Evropian.

Ish presidenti i Eurogroupe, një mjeshtër i vjetër i të fshehtave të Brukselit e din që ai është shumë i pritur për zgjedhjet e tij të BE-së për pesë vitet e ardhshme. Pas dy mandateve të José Manuel Barrosos, ai shpreson një Komision më të fortë dhe më politik.

Francezi Pierre Moscovici mori atë që Franca dëshironte, portofolin strategjik të çështjeve ekonomike dhe monetare, i ngarkuar me mbikëqyrjen buxhetore (rregulli famshëm i 3 % të defiçitit).

Gjermani Günther Oettinger mori ekonominë e novacionit dhe të IT-së,

një nga prioritetet e ardhshme të Komisionit. Britaniku Jonathan Hill nuk u servir keq, duke marrë shërbimet financiare, megjithë kritikën që bëri kryeministri britanik David Cameron kundër emërimit të Junckerit.

Ajo që bie në sy në këtë administratë të re është pesha e vendeve të Lindjes dhe të veriut. Polonia, e cila mori presidencën e Këshillit Evropian (Donald Tusk), mori postin e tregut të brendshëm, me ish zëvendës-kryeministren Elzbieta Bienkowska. Me suedezen Cecilia Malmström (tregtinë), e cila do të ushtrojë një mandat të dytë dhe danezen Margrethe Vestager, Skandinavia forcon praninë e saj në Bruksel me portofolin e konkurrencës.

Nuk ka “Riciklim”

Numri i “peshave të rënda” politike bie gjithashtu në sy, me gjithsej pesë kryeministra, (apo ish kryeministra) – nga të cilët sigurisht, Jean-Claude Junckeri – tre zëvendës-kryeministra dhe shumë ministra në funksion plotësojnë ekipin.

Këtë rradhë nuk mund të akuzohet Brukseli për “riciklim” politikash të padëshirueshme në vendet e tyre ... Shembulli që bie më tepër në sy është pa dyshim ai i finlandezit Jyrki Katainen, 43 vjeç i cili ka hequr dorë nga mandati i tij si kryeministër, për t’iu bashkuar ekipit të Brukselit.

Junckeri beson në një organizim të ri me emërimin e një grushti zëvendës-presidentësh, të ngarkuar sidomos për dosje të gjykuara prioritare.

Me “super-komisionerë” që do të kenë një rol koordinatorësh dhe përfaqsimi. Ato nuk disponojnë një drejtori të përgjithshme me disa qindra funksionarë në shërbimin e tyre, por që do të gëzojnë një pjesë të prerogativave të presidencës: aftësinë për të imponuar axhendën e tyre.

Qëllimi është që të arrihet në një organizim më të përqëndruar në sfidat e mëdha komunitare ... Ideja është prituri mirë në Bruksel, edhe pse ka ngritur pikëpyetje: A do të kenë sukses Zëvendës-presidentët, që të imponohen pa pasur administratë? A do të konsumohen ata në luftën për terri-tore me komisionerët mbi të cilët “ushtrojnë kontroll”? Vendet e mëdha – Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, të kujdesshëm si gjithmonë, kanë preferuar portofole “klasike”.

Disa vëzhgues në Bruksel e përshkruajnë ekipin e ri si “më ambiciozi qysh prej kohës të Jacques Delors” (nga viti 1985 deri në vitin 1994). Junckeri personalisht i gëzohet faktit që ai është presidenti i parë pak a shumë i caktuar më shumë nga zgjedhësit evropianë, se sa nga vetë kryetarët e shteteve, që kanë një legjitimitet që nuk i njihet.

Dosjet përvëluese

Komisioni i ardhshëm nuk duhet të humbasë kohë, pasi dosjet përvëluese grumbullohen. Duke filluar me krizën ukrainase. Episodi ukrainas, që nisi nga një tentativë partneriteti e negociuar me ngathtësi me Evropën, dhe i parë nga Moska si një akt agresioni, ka vërtetuar, thekson ekonomisti Andre Sapir, anëtar i një think-tanku në Bruksel, se BE –ja nuk ka “strategji globale në raport me fqinjët e saj, në një mjedis shumë të luhatshëm”.

Dosje tjetër prioritare janë ekonomia, ku aktualisht rritja ekonomike evropiane nuk po bën progres, papunësia ka mbetur në nivele të paprueshme dhe deflacioni po kërcënon.

Juncker njoftoi se Komisioni i tij do të ketë një orientim shumë ekonomik. Ai ka bërë një njoftim: dëshiron të vejë mbi shina një plan për një hov të ekonomisë prej 300 miliard euro, për tre vjet, që Evropa të mos shpenzojë më për infrastrukturën e saj energjetike, telekomunikatet etj.

Vendet e mëdha – Franca, Italia, Gjermania – e mbështesin këtë projekt. Por si do të luhet kjo muzikë? Nga do të merren 300 miliard euro, kur dihet që ato do të jenë veçse para publike? Temë tjetër e zjarrtë janë: si do të përmbushen kërkesat e paktit të stabilitetit dhe të rritjes ekonomike dhe vështirësitë e disa shteteve të mëdha anëtare – Franca dhe Italia, me ekonominë e dytë dhe të tretë në zonën euro – që do të diskutohen në shqyrtimin e buxheteve parashikuese të vitit 2015, të cilët do të paraqiten nga Komisioni qysh në muajin nëntor? “Shtetet e vogla anëtare denoncojnë



**Thellësia
e kësaj
ndarjeje
përsëritet
në Skandi-
navi. Atje
Norvegjia,
që ka 196
kilometra
kufi të për-
bashkët me
Rusinë, dhe
Finlanda,
që ka 1300
kilometra,
flasin dy
gjuhë të
ndryshme
strategjike**



tashmë një lexim me dy shpejtësi të traktateve : ato zbatohen për vendet e vogla dhe jo për ato të mëdha”, thekson një burim evropian.

Më në fund imigracioni është gjithashtu një dosje shumë urgjente. “Çështja është jashtëzakonisht delikate, por duhet që Evropa të pajiset mjete të vërtetë kontrolli të kufijve të saj”, vlerëson ekonomisti André Sapir. “Politikat tona të përbashkëta në fushën e imigracionit dhe të azilit nuk mund të funksionojnë në qoftëse ne nuk mund të pengojmë një fluks të pakontrolluar të imigrantëve të paligjshëm”, përgjigjet Juncker. Gjithësesi, shton ai, urgjenca humanitare është që të evitohen Lampeduza të tjera.

Njëzet e tetë antarët e organit ekzekutiv të BE-së

7 zëvendës-presidentë

Frans Timmermans Zëvendës presidenti i parë (Hollandë)

Andrus Ansip, Dixhital (Estonie)

Alenka Bratusek, Energji (Slloveni)

Valdis Dombrovskis, Euro (Letoni)

Kristalina Geogervia, Buxheti (Bullgaria)

Jiyrki Katainen, Rritja ekonomike (Finlandë)

Federica Mogherini, për politikën e jashtme (Italia)

Komisionerët e tjerë

Politika rajonale: Corina Cretu (Rumania)

Drejtësia: Vera Jourova (Republika Çeke)

Tregtia: Cecilia Malmström (Suedi)

Konkurenca: Margarethe Vestager (Danimarkë)

Energjia dhe ndryshimi klimatik: Miguel Arias Canete (Spanjë)

Shërbimet financiare: Jonathan Hill (Britania e Madhe)

Arsimi: Tibor Navracsics (Hungari)

Aksioni humanitar: Chrystos Stylianides (Qipro)

Migracioni, të drejtat dhe çështjet e brendshme:

Dimitris Avramopoulos, (Greqi)

Bujqësia: Phil Hogan (Irlandë)

Dixhitali: Günther Oettinger (Gjermani)

Tregu i brendshëm: Elzbieta Biekowska (Poloni)

Punësimi dhe çështjet sociale: Marianne Thyssen (Belgjikë)

Kërkimi shkencor : Carlos Moedas (Portugali)

Çështjet detare dhe peshkimi: Karmenu Vella (Maltë)

Bashkëpunimi: Neven Mimica, (Kroaci)

Ekonomia dhe çështjet monetare: Pierre Moscovici (France)

Transportet: Maros Sefcovic (Sllovaki)

Politika e fqinjësisë: Johannes Hahn (Austri)

Shëndetësia dhe siguria ushqimore: Vyentis Andriukaitis (Lituani)

“
Qëllimi është
që të arrihet në
një organizim më
të përqëndruar
në sfidat e mëdha
komunitare ...
Ideja është pritur
mirë në Bruksel,
edhe pse ka ngri-
tur pikëpyetje:
A do të kenë
sukses Zëvendës-
presidentët, që
të imponohen
pa pasur admi-
nistratë? A do
të konsumohen
ata në luftën
për territore me
komisionerët mbi
të cilët “ushtrojnë
kontroll”? Vendet
e mëdha – Fran-
ca, Gjermania,
Mbretëria e
Bashkuar, të
kujdesshëm si
gjithmonë, kanë
preferuar porto-
fole “klasike
”



Europa nuk duhet ta harrojë Mesdheun

EMMA BONINO

Përshkallëzimi i konflikteve dhe tensionet në Libi, Siri, Egjipt, Irak dhe Palestinë na shqetësojnë në shumë pikëpamje. Siguria, çrregullimet në furnizimin me naftë, imigracioni janë vetëm një pjesë e frikës tonë.

Roli i Bashkimit Evropian në rajonin mesdhetar mbetet gjithmonë shumë i pavendosur: ai është i paaftë të na japë një minimum garancie në sfidat e shumta.

Duke udhëtuar nga një cep në tjetrin të Lindjes së Mesme dhe në Afrikës Veriore gjatë muajve të fundit – nga Maroku në Turqi, si dhe në Arabinë Saudite – unë e kam vëzhguar situatën me lupë.

Një botë e re, shumë komplekse dhe krejtësisht thelbësore për Evropën, qëndron disa qindra kilometra larg nesh. Megjithë situatën dramatike në të cilën është zhytur Ukraina, unë e vlerësoj thelbësore që BE të përqëndrohet me urgjencë në kufirin jugor të Mesdheut, dhe të shpallë një strategji krejtësisht të re.

Pa dyshim, mund të diskutojmë për një kohë të gjatë për dështimin e politikës evropiane të fqinjësisë përballë këtij rajoni, por nuk mundemi të kemi më luksin e pritjes. Paraprakisht, krahas çdo përpjekje tjetër, është e nevojshme që ne të ndërgjegjësohemi për rëndësinë e zhvillimeve që po ndodhin në rajon, megjithëse ky mutacion shfaqet në forma të ndryshme, sipas vendeve.

Qysh me fillimin e zgjimit arab në vitin 2011, po asistojmë në një luftë të vërtetë influence në gjirin e komunitetit sunit. Katari dhe Turqia, aleatët kryesorë të Vëllazërisë Myslimane, pra të Hamasit, të Ennahda-s, të presidentit Morsi të rrëzuar nga pushteti, janë përballur me partizanët tradicionalë salafistë: Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Sfidë është supremacia ekonomike dhe gjeostrategjike në rajon, duke përfshirë këtu dhe Libinë.

Aktorët e rinj rajonalë (Katari, Turqia, Arabie Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe) kanë fituar një fuqi ekonomike dhe mediatike të paprecedentë, ndërkohë që Perëndimi (sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës) ruan vetëm një superioritet ushtarak, që shpesh është përdorur në mënyrë të ngathët.

Këto janë vende të cilat në përgjithësi veprojnë jashtë të drejtës ndërkombëtare humanitare. Në Egjipt, janë salafistët me aleatët e tyre të fuqishëm, të cilët kanë fituar për momentin. Në vendet e tjera të rajonit, si Tunizia, kemi një situatë tranzicioni të brishtë, në Algjeri një status quo të pasigurt.

Duhet që Evropa të fillojë një politikë krejtësisht të re – e cila nuk mund të zbatohet kudo, nga Gjeorgjia në Algjeri – boshti i së cilës nuk mund të jetë imigracioni. Zbarkimet klandestine, imigracioni i paligjshëm janë vetëm maja e ajsbergut: miliona njerëz po përpiqen t'i largohen luftës, urisë, dhe diktaturave.

Ato janë të destinuar të mos kthehen në vendet e tyre, edhe nëqoftëse ndërtohet një mur në mes të detit Mesdhe.

Prioritetet e vendosura nga Bashkimi Evropian në vitin 2011, të përmbledhura në “3M” - Money, Market Access, Mobility (“para, akses në tregjet, lëvizshmëri”) -, për partnerët janë dekurajuar me të drejtë. Ato nuk kanë parë as para, as dhe akses në tregjet. Përsa i përket lëvizshmërisë, nëse misioni Mare nostrum, i lancuar nga Italia, nuk do të zgjerohet, Mesdheu ende do të jetë një det i mbushur me të vdekur.

Ne duhet të forcojmë mbështetjen tonë për vendet që dëshirojnë të dalin nga situata ku gjenden, si Maroku, Tunizia, Jordania dhe Libani, dhe të rinisë sa më shpejt procesin e anëtarësimit të Turqisë.

Me qëllim që objektivi ynë të vihet në lëvizje për t'u realizuar duhet kurajo, shpejtësi dhe durim. BE-ja ka nevojë për një instrument të ri, domethënë për një komisioner për Mesdheun në kohë të plotë, i pajisur me një strukturë të përshtatshme, në gjendje të futet në labirintin e buxhetit evropian dhe të hartojë politika të reja dypalëshe.

Qeveritë të cilat janë të mendimit për një komisioner për imigracionin, bëjnë një rrugë të gabuar duke privilegjuar një përjasje sigurie, e cila nuk ka asnjë dobi.

Edhe pse ne nuk jemi në këtë çast një aktor vendimtar në rajon në afat mesëm, ne mund të kemi një ndikim në shumë vende. Në Egjipt, në Iran apo gjetkë, është Evropa dhe jo Arabia Saudite, e cila është perceptuar si model reference.

Një program “Erasmus për Mesdheun”, forcimi i qëndrave tona lokale kulturore mund të jetë një përpjekje e parë për të konsoliduar lidhjet dhe për të krijuar besim. Është vetë Evropa e cila provon se pagja dhe prosperiteti qëndrojnë në integrimin progresiv të tregjeve dhe në marrëdhëniet e pasura kulturore dhe njerëzore.

Përfundimisht, në situatën aktuale, e vetmja zgjidhje e mundshme për Evropën konsiston në braktisjen e sistemit të sferave të influencës, dhe ruajtjen e parimit të ndarjes së përgjegjësisë. /Liberation/

“
**Prioritetet
e vendosura
nga Bashkimi
Evropian në
vitin 2011, të
përmbledhura në
“3M” - Money,
Market Access,
Mobility (“para,
akses në tregjet,
lëvizshmëri”)
-, për partnerët
janë dekurajuar
me të drejtë. Ato
nuk kanë parë
as para, as dhe
akses në tregjet.
Përsa i përket
lëvizshmërisë,
nëse misioni
Mare nostrum,
i lancuar nga
Italia, nuk do
të zgjerohet,
Mesdheu ende do
të jetë një det i
mbushur me të
vdekur**
”



A mund ta mposhtim Shtetin Islamik?

FAREED ZAKARIA

Ja tek jemi përsëri. SHBA i kanë shpallur luftë një tjetër grupi terrorist. Fjalimi i Presidentit Obama të mërkurën në mbrëmje parashtroi një strategji të fortë, të mirëmenduar për t'iu kundërvënë Shtetit Islamik – i cili është rrezik për rajonin dhe më tej. Por le të sigurohemi gjatë zbatimit të kësaj strategjie, që të mësojmë diçka nga 13 vitet që kanë kaluar qysh prej 11 shtatorit 2001, dhe luftës ndaj al Kaedës. Ja disa mësimet për të cilat duhet menduar.

Mos e hani gjithmonë karremën. Në një prej fjalimeve të filmuar që u drejtonte ndjekësve të tij, Osama bin Ladeni parashtroi strategjinë e tij. “Ajo që duhet të bëjmë është që të dërgojmë dy muxhahedinë në pikën më të largët në lindje, për të ngritur një copë leckë ku të hetë shkruajtur al Kaeda”, tha ai. “Kështu do i bëjmë gjeneralët amerikanë që të rendin drejt asaj pike”.

Qëllimi i filmimeve të frikshëm të ekzekutimit të gazetarëve ishte që të provokonin SHBA. Dhe funksionoi. Në fund të fundit, nuk ka ndryshuar asgjë në muajt e fundit, në lidhje me shtetin e vetëshpallur islamik dhe rreziqet që ai paraqet – përveç shfaqjes së këtyre filmimeve. Megjithatë, ato e shtynë Uashingtonin të vihet në lëvizje. Studiuesi Favaz Gerges shkruan se disa muaj më parë, al Baghdadi vërente se organizata e tij nuk ishte e gatshme të sulmonte Amerikën, por “shpresonte që SHBA do të dërgonte ushtarë në terren me qëllim që ISIS të luftonte drejtpërdrejt me amerikanë

– dhe t'i vrasë ata”.

Ne duhet të veprojmë kundër këtij grupi terrorist. Por le ta bëjmë në një kohë dhe një mënyrë që e zgjedhim vete ne, dhe jo të kërcejmë kur ata duan që ne të kërcejmë.

Mos e mbivlerëso armikun. Shteti Islamik, i njohur edhe si ISIS apo ISIL, është një armik i fortë, por kundërforcat ndaj tij sapo janë vënë në lëvizje. Dhe këse këto forca – ushtria irakene, pesh mergat kurdë, forca ajrore e SHBA – punojnë në mënyrë të bashkërenduar, ai do të fillojë të humbasë terren. Gjithashtu, mbani parasysh që në realitet nuk zotëron aq shumë terren sa tregojnë hartat që na shfaqen në televizione. Pjesë të mëdha të atyre “territoreve” janë shkretëtira. Në Irak dhe Siri, qytetet janë të ngritur buzë lumenjve.

Ndërkohë që Shteti Islamik është shumë më i sofistikuar se sa al Kaeda në operacionet dhe teknologjinë e tij, ai ka një dobësi të madhe. Al Kaeda ishte një organizatë Pan-Islamike, që përpiqej të jositë të gjithë myslimanët. Ky grup është një organizatë sektare. Është një pasardhëse e al Kaedës në Irak, e cila u krijua nga Abu Musab al Zarkavi, me një mision anti-shiit. Në fakt, kjo është arsyeja përse al Kaeda u nda prej al Zarkavit, duke i bërë thirrje atij që mos të bënte armiq bashkëbesimtarët myslimanë. Shteti Islamik është anti-shiit, por edhe shumë armiqësor ndaj kurdëve, të krishterëve dhe shumë banorëve të tjerë të Lindjes së Mesme. Kjo do të thotë se ka një numër të madh armiqsh në rajon që do të luftojnë kundër tij, jo se duan SHBA, por për shkak të vetë interesave të tyre.

Mos harroni politikën. Veprimi ushtarak duhet të shoqërohet me një strategji të mençur politike. Shteti Islamik është një pasojë direkte e pushtimit amerikan të Irakut dhe vendimeve rrënues politikë për të shpërbërë ushtrinë irakene dhe “de-Baathizuar” burokracinë e saj. Rezultati ishte një popullsi sunitë e zemëruar, pa kompetenca e cila nisi kryengritjen. Disa media kanë transmetuar kohët e fundit intervista me sunitë të Irakut që thonë se pavarësisht gjithë kaosit, ishin më të lumtur nën Shtetin Islamik se sa nën “ushtrinë shiite”. Kështu e quanin qeverinë irakene.

Administrata Obama ka hartuar një strategji të mençur për Irakun, duke i bërë presion qeverisë së Bagdadit që të afrojë më shumë sunitë. Por kjo ende nuk ka ndodhur – partitë shiite nuk janë shumë gati të bëjnë lëshime të mëdhenj për sunitët. Ushtria irakene nuk është riformuar për të qenë më pak partizane dhe sektare dhe më shumë gjithëpërfshirëse dhe efektive. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme, sepse nëse SHBA shihen sikur po mbrojnë dy regjime josunitë – Irakun dhe Sirinë – kundër një kryengritjeje

“Mos harroni politikën. Veprimi ushtarak duhet të shoqërohet me një strategji të mençur politike. Shteti Islamik është një pasojë direkte e pushtimit amerikan të Irakut dhe vendimeve rrënues politikë për të shpërbërë ushtrinë irakene dhe “de-Baathizuar” burokracinë e saj. Rezultati ishte një popullsi sunitë e zemëruar, pa kompetenca e cila nisi kryengritjen. Disa media kanë transmetuar kohët e fundit intervista me sunitë të Irakut që thonë se pavarësisht gjithë kaosit, ishin më të lumtur nën Shtetin Islamik se sa nën “ushtrinë shiite”. Kështu e quanin qeverinë irakene
”





sunite, atëherë nuk do të fitojë. Dhe do të jetë e vështirë të rekrutohen aleatë lokalë. Ndërkohë që janë pakicë në Irak, sunitët janë shumicë dërrmuese mes myslimanëve të Lindjes së Mesme.

Aspekti sirian i strategjisë së Presidentit është edhe hallka e dobët e saj. Është e pamundur të luftosh Shtetin Islamik, dhe të mos forcosh praktikisht regjimin e Bashar al Assadit. Ne mund të themi se nuk kemi për qëllim ta bëjmë këtë gjë, por kjo nuk e ndryshon realitetin në terren. Ushtria e Lirë Siriane mbetet e dobët dhe e ndarë mes shumë grupeve lokale.

Obama premtoi të “degradojë” shtetin islamik. Shumë mirë. Ai premtoi gjithashtu që në fund “ta shkatërrojë” atë. Ne nuk kemi qenë në gjendje të heqim qafe al Kaedën. Dhe shkatërrimi i një grupi si ky kërkon eliminimin e dinamikave sektare që e nxisin. Kjo nuk i takon Uashingtonit, por ai mund të ndihmojë që të ndodhë duke u bërë presion irakenëve dhe duke afruar sauditët dhe fuqi të tjera rajonale.

Ndërhyrja ushtarake e Obamës në rajon do të funksionojë nëse do të ketë një ndërhyrje politike ekuivalente, apo ndoshta edhe më e fortë. / Washington Post/



Aleatët arabë dhe dora e Iranit. Pakti i habitshëm...

BERNARDO VALLI

Parashikohej prej kohësh. Përshpejtimi ndodhi prej situatës shumë të rëndë ushtarake në Irak. Tani, shtrirja e ofensivës ajrore amerikane në Siri i jep të gjithë atributet e një lufte, tentativës për frenimin dhe me kalimin e kohës shkatërrimin e shtetit të vetëshpallur islamik. Kohëzgjatja? Do të ishte e guximshme të bëheshin parashikime. Barack Obama është matur shumë. Sa i përket zhvillimeve, presidenti i SHBA nuk duket se ka dyshime. Ai nuk dëshiron t'u lërë as edhe një "strehë" terroristëve. Por është një sipërmarrje që kërkon kohë dhe rrezikon të përfundojë në duart e kreut të ardhshëm të Shtëpisë së Bardhë.

Një ndërhyrje më e madhe, e mbështetur edhe prej vendeve arabë, sidoqoftë ishte e detyrueshme. Madje ishte urgjente. Në planin politik dhe ushtarak. Zgjerimi i konfliktit në një pjesë të madhe të Tigris dhe Eufratit, Gjysmëhëna pjellore e historianëve, një herë e një kohë "djepi i qytetërit" por e shndërruar në luginë të tragjedi, nuk arrin megjithatë që të largojë konfuzionin e krijuar prej një lëmshi aleancash dhe lojërash të dyfishta.

Mbështetja ajrore e SHBA në gjashtë javët e fundit ka bërë të mundur që forcat e armatosura irakene dhe militantët kurdë të ndalin marshimin drejt Bagdadit të trupave të "kalifatit", por nuk ka shmangur humbje të rënda në pjesën tjetër të Irakut. Deri në atë pikë sa që qeveria kombëtare,

“
Pasiviteti i popullsisë sunite, apo edhe bashkëpunimi i saj, kanë favorizuar dhe vazhdojnë të favorizojnë forcat xhihadiste të kalifatit, që është vetë shprehje e ekstremizmit sunit. Solidariteti më shumë komunitar se sa fetar, me një mozaik fisesh dhe mbetjeve të Saddam Huseinit, që kërkojnë një revansh ndaj shiitëve, është një armë efikase në duart e Shtetit Islamik. Në jug të Sirisë, ky i fundit ka fituar terren duke shkaktuar eksodin e popullsisë kurde drejt Turqisë
 ”

duke humbur terren nuk kontrollon më një të katërtën e vendit. Në provincat me shumicë sunite, sidomos ajo e Anbarit, ngjitur me kryeqytetin, njësi të tëra janë rrethuar dhe një pjesë e tyre janë asgjësuar. Edhe me ekzekutime në masë.

Pasiviteti i popullsisë sunite, apo edhe bashkëpunimi i saj, kanë favorizuar dhe vazhdojnë të favorizojnë forcat xhihadiste të kalifatit, që është vetë shprehje e ekstremizmit sunit. Solidariteti më shumë komunitar se sa fetar, me një mozaik fisesh dhe mbetjeve të Saddam Huseinit, që kërkojnë një revansh ndaj shiitëve, është një armë efikase në duart e Shtetit Islamik. Në jug të Sirisë, ky i fundit ka fituar terren duke shkaktuar eksodin e popullsisë kurde drejt Turqisë.

Pra ishte e domosdoshme që të goditej sa më shpejtë të ishte e mundur kundërshtari në territoret e tij siriane, në provincën jugore të Raqqas, “kryeqyteti” i Shtetit Islamik. Prej ku vijnë urdhërat dhe ndihmat. Dhe ishte po kështu urgjente që në operacione të përfshiheshin vendet arabë sunite, për të qartësuar dëshirën e tyre të vendosur, me armë në duar, për t’u dalluar prej ekstremizmit sunit. Duke u vetëshpallur kalifat, ai është vendosur mbi të gjithë shtetet myslimanë, dhe praktikisht ka fshirë kufijtë duke qenë se autoriteti i Kalifit përfshin të gjithë Islamin. Vetëshpallja ka përplasur traditën dhe ndjeshmëritë. Në shumë kryeqytete është shfaqur si një uzurpim. Një blasfemi. Pjesëmarrja e Bahreinit, e Jordanisë, Katarit, Emirateve të Bashkuar Arabë dhe mbi të gjitha Arabisë Saudite në inkursionet në Siri ka qenë një deklaratë e hapur lufte ndaj atyre që, duke ushtruar terrorizmin, janë vetëshpallur pasardhës të Profetit, e si pasojë ka vendosur vehten në një pozicion superioriteti në krahasim me vetë ruajtësit e Mekës dhe Medinës.

Dinjiteti i fyer i presidentëve, sovranëve dhe emirëve është megjithatë i huaj për ndjenjën e popullsisë, të vëmendshme ndaj thirrjeve më të guximshme fetare. Prej kësaj edhe numri i madh i pjesëmarrësve në koalicionin e madh që nxitet nga amerikanët, të cilët nuk duan të ekspozohen shumë.

Barack Obama ka qenë i sjellshëm, ka thënë se janë afro 40, pa përmendur emrat. Pesë vendet që kanë dërguar avionët e tyre mbi Siri janë në pararojë të një loje jo të vogël, por pjesa më e madhe e botës arabe nuk ka guxuar të shkojë përtej deklaratave parimore apo ndihmave indirekte, dhe sa më anonime të jetë e mundur. Solidariteti i tyre i rezervuar është gjithësesi shumë i vlefshëm.

Barack Obama ka mundur të pohojë se në luftë nuk janë vetëm SHBA. Ka shtuar se do të bëjë gjithcka për të garantuar sigurinë e anëtarëve të koalicionit të madh, të rajonit dhe “të të gjithë botës”. Ndonëse ambicioz, angazhimi duhej të ishte më eksplicit. Konflikti nuk është i kufizuar në fushëbetejën siriano-irakene. Degëzimet e Shtetit Islamik janë të mëdha dhe të paparashikueshme. E ka zbuluar këtë orët e fundit rrëmbimi dhe ekzekutimi i pengut francez në Algjeri, nga ana e një organizate që thotë se frymëzohet prej kalifatit të largët të Raqqas.

Grupi origjinal, “kalifati”, mund të eliminohet apo dobësohet prej bombave të telekomanduara të avionëve pa pilot dhe raketave të US Navy, por për të neutralizuar patologjinë vrasëse të islamizmit do të duhen armë të tjera dhe një kohë më e gjatë. Terreni i përplasjeve është më i gjerë se sa Gjysmëhëna pjellore, e pagëzuar kështu prej formës së saj gjeografike dhe bujarisë së të korrave, që në ndërkohë kanë rënë dhe janë zëvendësuar prej naftës.

Bashkë me Shtetin Islami, SHBA kanë bombarduar grupin e armatosur Khorasan të përbërë nga ish militantë të al Kaedës. Kreu i tij, Muhsin al Fadhli ishte i ri, vetëm 19 vjec në 11 shtator 2001, por me sa duket ka patur një rol në organizatën që sulmoi Kullat Binjake. Lufta civile ka krijuar në Siri një numër të pasaktësuar lëvizjesh islamike. Shpesh herë në konkurrencë mes tyre. Të gjithë thonë se i kundërvihen forcave qeveritare të Damaskut dhe konsiderojnë Assadin si armikun e tyre kryesor, por në të



njëjtën kohë përplasen, në brendësi të rebelimit, me ata me të cilët nuk i ndajnë idetë. Tensioni është i madh. Më shumë në shënjestër është Koalicioni kombëtar, i konsideruar laik, të cilin amerikanët kanë vendosur ta furnizojnë me armë.

Është krijuar kështu një situatë, në të cilën SHBA bombardojnë dhe njëkohësisht ndihmojnë opozitën. Bombat janë për forcat xhihadiste dhe mbështetja është për të moderuarit. Të cilët vriten mes tyre, xhihadistë kundër laikëve, dhe në të njëjtën kohë luftojnë secili për hesap të vet kundër Assadit. Amerikanët e përjashtojnë aksionin e tyre me presidentin sirian. Refuzojnë të bashkëpunojnë me të. Barack Obama e ka akuzuar se torturon njerëzit e tij dhe i ka mohuar cdo lloj legjitimiteti. Por Damasku siguron se është informuar nga Uashingtoni për sulmin ndaj Shtetit Islamik dhe Bashar al Assadi thotë se është në favor të “cdo përpjekjeje kundër terrorizmit ndërkombëtar”. Pra, deklarohet i kënaqur për inkursionet amerikane kundër kalifatit.

Bashar al Assadi, si alavit, që i përket një komuniteti të zonës shiite, ka si aleat kryesor iranianin Hasan Rohani. I cili është megjithatë më realist se mbreti. E denoncon si të paligjshëm sulmin amerikan në Siri, sepse ndodh pa autorizimin e Damaskut. Kontradiktat, lojërat e dyfishta, deklaratat false janë të shpeshta. Irani është në dukje i përjashtuar nga lojërat, por militantët shiitë nën ndikimin e tij apo urdhërat e tij, luftojnë në terren kundër Shtetit Islamik dhe me mbështetjen ajrore “të pa bashkërenduar” të amerikanëve. Dhe në sintoni të dukshme me Arabinë Saudite. Ky lajm i fundit, nëse do të konfirmohet, do të ishte një risi e madhe në Lindjen e Mesme. Sauditët, kampionë të sunitëve, bashkëpunojnë me iranianët, kampionë të shiitëve. Dy armiq flasin nën tryezë, për të eliminuar kalifatin.

/la repubblica/



Rendi botëror, sipas Henry Kissingerit

JONATHAN POWELL

Henry Kissinger është pothuajse unik në politikën bashkëkohore, në kombinimin e intelektit të thellë dhe një përvojë të jashtëzakonshme si burrë shteti. Libri i tij më i fundit është po aq autoritar sa gjithë të tjerët, ndonëse goxha më i shkurtër – më pak se gjysma e klasikut të tij, “Diplomacia”.

Nëse ligjet e natyrës vlejnë, ky do të jetë me shumë gjasë libri i tij i fundit – Kissinger është 91 vjeç – dhe Rendi Botëror është një përpjekje për të bashkuar të gjithë veprën e jetës së tij, në një koncept teorik. Libri është “veshur” si një kërkim për një rend të ri global që mund të përfshijë të gjithë rendet ekzistues rajonalë. Por ai është, në fakt, një përpjekje për të justifikuar gjithçka që ai ka bërë – nga Kina në Vietnam, si diplomat apo si Sekretar Shteti – apo ka argumentuar, gjatë pothuaj shtatë dekadave të fundit.

Kissingeri galopon nëpër historinë europiane nga viti 474 p.e.s deri në ditët e sotme, në vetëm 84 faqe. Për të, momenti i kthesës ka qenë Paqja e Vestfalisë e vitit 1648, që i dha fund luftës 30-vjeçare mes katolikëve dhe protestantëve me një marrëveshje që shtetet nuk do të ndërhyjnë më në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Në vend të kërimit për një sistem universal, si një Kinë Imperiale apo në Islamin e hershëm, Europa zhvilloi një sistem pluralist shtetesh që konkurronin mes tyre. Rendi ndërkombëtar

“
**Ai beson se e
 vetmja mënyrë
 për të shmangur
 përsëritjen e
 historisë, qëndron në krijimin
 e një lloji të ri
 marrëdhëniesh
 mes fuqive të
 mëdha, bazuar
 në sistemin e
 Vestfalisë dhe
 ekuilibrit të fuqive,
 që tani duhet
 të zbatohet
 globalisht dhe jo
 vetëm rajonalisht.
 Megjithatë,
 ajo që e bën
 librin interesante,
 nuk është
 ky argument
 sipërfaqësor por
 nënteksti, teksa
 Kissingeri përpikë
 që të justifikojë
 tre temat
 e mëdha që kanë
 dominuar mendimin
 dhe veprën e
 jetës së tij**
 ”

po ruhej përmes një ekuilibri të fuqive. Më e rëndësishmja, Vestfalia ndau politikën e jashtme nga politika e brendshme.

Kapitujt e mëpasshëm mbulojnë konceptin e rendit botëror në Islamit e hershëm – “në të njëjtën kohë një shtet, një super shtet shumëetnik dhe një rend i ri botëror” – në Persi, në Azi dhe në fund në qasjen amerikane – “e bindur se parimet e saj të brendshme ishin natyrshëm universale”.

Vende-vende, libri duket “i prishur” pak prej një përpjekjeje që ta përditësojë “fort” me shtesa të minutës së fundit, si për shembull përparimi i ISIS, ndërkohë që vlera e vërtetë e librit qëndron pikërisht në perspektivën historike të Kissingerit. Gjithashtu, ai është më pak bindës sa i përket parashikimeve që bën për të ardhmen e secilit kontinent, e që tentojnë të reduktohen në një listë pyetjesh.

Kissinger argumenton se tani ndodhemi në një pikë kthese historike. SHpërbërja e Bashkimit Sovjetik nuk solli fundin e historisë, dhe pranimin e përgjithshëm të vlerave perëndimore. Në vend të kësaj, rendi ynë botëror liberal po sfidohet prej fuqive të reja. Kissingeri sheh rrezikun kryesor teksa fuqia në ngjitje, Kina ecën drejt përplasjes me fuqinë e status quo-së, SHBA-në, ashtu sikurse Gjermania bëri me Britaninë në fillimin e shekullit 20. Kina, thotë, ai, refuzon rolin që i është atribuar nga një sistemi ndërkombëtar që ajo nuk e ka skicuar, dhe ajo nuk pranon rregulla, në hartimin e të cilave nuk ka patur asnjë rol.

Ai beson se e vetmja mënyrë për të shmangur përsëritjen e historisë, qëndron në krijimin e një lloji të ri marrëdhëniesh mes fuqive të mëdha, bazuar në sistemin e Vestfalisë dhe ekuilibrit të fuqive, që tani duhet të zbatohet globalisht dhe jo vetëm rajonalisht. Megjithatë, ajo që e bën librin interesant, nuk është ky argument sipërfaqësor por nënteksti, teksa Kissingeri përpikë që të justifikojë tre temat e mëdha që kanë dominuar mendimin dhe veprën e jetës së tij.

E para është gara në diplomaci mes realistëve dhe idealistëve. Heronjtë e zgjedhur prej tij, përfshirë Richelieu-në, Tayllorand-in dhe Metternich-un si dhe Teddy Rooseveltin, e bëjnë të qartë se cili është qëndrimi i tij. Kissingeri përçmon Uilsonin, themeluesin e “degës” idealiste të politikës së jashtme amerikane. Kissingeri beson se idealizmi i tepruar në politikën e jashtme është i rrezikshëm: ‘Recetat morale pa e vlarë mendjen për ekuilibrin... kanë prirjen që të çojnë ose drejt kryqëzatave, ose drejt një politike të pafuqishme’. Kissingeri ilustron besimin e një jete tek Realpolitika, përmes një kritike të qasjes së Perëndimit ndaj Pranverës Arabe, ku ai mendon se u treguam jo të mençur teksa u udhëhoqëm prej idealizmit.

Tema e dytë është magjepsja e Kissingerit pas ekuilibrit të fuqive si një sistem për menaxhimin e marrëdhënieve mes shteteve, temë e punimit të tij të parë si një akademik i ri mbi Kongresin e Vienës, i cili ka prodhuar periudhën më të gjatë të paqes në Europë. Kissingeri beson se ky nuk është vetëm një sistem i përshtatur për Europën e shekullit 19, por një sistem i pakohë dhe universal. Sigurisht, triumfi më i madh i politikës së jashtme që mban firmën e atij vetë ka qenë zhvendosja e ekuilibrit të fuqive në drejtim të Amerikës, duke e larguar Kinën prej Bashkimit Sovjetik në vitin 1972.

Tema e tretë është parimi i mosndërhyrjes, që ndodhet në themel të sistemit vestfalian. Kissingeri flet me admirim për funksionimin e sistemit në Azinë moderne, që do të thotë se dallimet mes shteteve zgjidhen përmes ndërveprimit të heshtur diplomatik dhe jo përmes luftës (ai nuk përmend koston e tolerimit të diktaturave të tmerrshme). Kissingeri thekson vlerësimin e madh që ka për Xhorxh Bushin e ri, por më tej kritikon politikat e tij intervencioniste në Afganistan dhe Irak.

Kissingeri i argumenton në mënyrë brilante të gjithë këto tema. Por në fund, është e vështirë të biesh dakord me të, që një rend i ri botëror kërkon të kthehemi pas në sistemet e shekujve 18 dhe 19. Bota ka ndryshuar – ai as nuk e përmend terrorizmin, një prej sfidave më të mëdha të botës së sotme. Nuk është e lehtë as të biesh dakord me relativizmin e tij moral. Ai



dëshiron të shmangë një garë globale të ideologjive – por ne pikërisht këtë kemi, dhe rendi botëror kinez nuk është aspak i njëjtë me tonin. Të rinjtë nëpër botë mund të blejnë produkte kinezë, por ata nuk do të donin të jetonin nën një sistem kinez.

Kissingeri argumenton kundër valës së historisë. Ai ankohet se ndarja mes politikës së brendshme dhe politikës së jashtme po shkon drejt zhdukjes. Por njerëzit nëpër botë thjeshtë nuk janë gati që të rrinë e të vështrojnë gjenocidin në Ruandë apo masakrat në Bosnje, pa lëvizur gishtin në emër të parimit të mos-ndërhyrjes. Zhvillimi i “Të drejtës për të mbrojtur”, që nga ndërhyrja e Perëndimit në Kosovë në vitin 1999 do të thotë që debati ka evoluar dhe sistemi vestfalian po shkon drejt varrosjes. Ka më shumë gjasa që në të zhvillojmë një sistem tonin, se sa të rikthehemi, siç sugjeron Kissingeri, në një rend botëror të të kaluarës. / The Telegraph/



Shthurja e madhe

ROGER COHEN

Ishte koha e shthurjes. Shumë kohë më vonë, në mesin e rrënojave, njerëzit pyesnin: Si ndodhi vallë?

Ishte koha e prerjes së kokave. Me një lëvizje të beftë të dorës së majtë, në një sfond shkretëtire, në dritë të diellit, një mysliman me theks britanik preu kokat e dy gazetarëve amerikanë dhe një punonjësi britanik. Xhihadi-sti dukej rehat në punën e tij, nuk e kishte me nxitim. Viktimat ishin thyer. Terrori është teatër. Qiellgërvishtës që digjen, koka që priten: Terroristi merr pamje filmike të një lehtësie të padurueshme dhe u jep peshën e mjaftueshme, për t'i ngulitur në psikikën tonë.

Ishte koha e agresionit. Udhëheqësi i kombit më të madh mbi tokë deklaroi se vendi i tij ishte i rrethuar, madje i poshtëruar. Ai aneksoi një pjesë të një vendi fqinjë, akti i parë i këtij lloji në Europë që nga viti 1945, dhe shkaktoi një luftë pak më tutje, në toka që i lakmonte. Njerëzit që mbështeste ai rrëzuan një avion civil pasagjerësh. Viktimat, shumë prej tyre europianë, u lanë të kalben nën diell për ditë të tëra. Ai mohoi të kishte gisht në aktet e dhunës, ashtu si aktori me kukulla që mohon se lëvizjet e kukullave kanë lidhje me lëvizjet e tij. Ai përmendi ligjin, por më pas e shkeli me këmbë. Ai përmendi historinë, por më pas e ktheu në farsë.

Ishte koha e ndarjes. Unioni më i suksesshëm në histori, i krijuar mbi një ishull në Detin e Veriut në 1707-ën, shkoi drejt ndarjes së mundshme – jo sepse kishte dështuar (që nga deti vazhdojnë të vijnë refugjatë që e ëndër-

“
**Ishte një kohë
 dobësie. Kom-
 bi më i fuqi-
 shëm në botë
 ishte i lodhur
 nga luftërat e
 largëta, vullneti
 dhe thesari i tij
 ishin tkurrur
 prej mungesës
 së fitores. Një
 botë mosmirën-
 johësve mund
 të bënte poli-
 cin e vetvetes.
 Kombi i madh
 kishte ura për të
 ndërtuar dhe si-
 steme arsimorë
 për të ndrequr.
 Luftërat civile
 mes arabëve
 mund të qel-
 beshin. Armiqtë
 mund të vrisnin
 madje armiqtë e
 tjerë, një fito-
 re me kosto të
 ulët. Kufijtë në
 Lindjen e Me-
 sme mund të
 shuheshin; ato
 ishin thjeshtë
 vija artificiale
 koloniale mbi
 një hartë
 ”**

rojnë), as edhe për shkak të urrejtjes mes popujve të tij. Qytetarët më veriorë ishin mërzitur. Ata ishin të pakënaqur. Ata ishin të lodhur nga jugu dhe kryeqyteti i tij i parasë, që për ta ishte një emblemë e globalizimit dhe pabarazisë.

Ata imagjinuan se duhej të kontrollonin Shërbimin e tyre Shëndetësor Kombëtar, me qëllim që ta shpëtonin, ndonëse tashmë e kishin nën kontroll prej decentralizimit dhe mund të kishin në fakt më pak para për mbajtjen e tij (jo se ishte i kërcënuar) si shtet i pavarur. Fakti që monedha, borxhi, të ardhurat, mbrojtja, aftësia paguese dhe anëtarësimi në Bashkimin European i këtij shteti të sapolindur ishin të gjithë në dyshim, u duk se nuk peshoi shumë mbi një vendim të udhëhequr prej emocioneve, prej nevojave, prej një dëshire për t’u dëgjuar në kakoфонinë moderne – dhe në djallë shkofte e nesërmja. Nëse gjithë të tjerat dështonin, nafta do t’i shpëtonte (gjithmonë nëse nuk e kishte në zotëri dikush tjetër, apo nëse nuk shteronte).

Ishte një kohë dobësie. Kombi më i fuqishëm në botë ishte i lodhur nga luftërat e largëta, vullneti dhe thesari i tij ishin tkurrur prej mungesës së fitores. Një botë mosmirënjohësve mund të bënte policin e vetvetes. Kombi i madh kishte ura për të ndërtuar dhe sisteme arsimorë për të ndrequr. Luftërat civile mes arabëve mund të qelbeshin. Armiqtë mund të vrisnin madje armiqtë e tjerë, një fitore me kosto të ulët. Kufijtë në Lindjen e Mesme mund të shuheshin; ato ishin thjeshtë vija artificiale koloniale mbi një hartë. Shiitët mund të luftonin me sunitët, dhe sunitët me shiitët, nuk i ndalje dot ata. Ashtu si luftërat fetare disa-dekadëshe në Europë, edhe këto luftëra duhej të liheshin të bënin të tyren. Lideri i kombit përqeshi qasjen e tij “të zbehtë, mosbesuese, prej profesori” ndaj botës, duke lënë të kuptohet se ai nuk është asnjë prej këtyre, ndonëse këtë përshtypje të krijonte. Ai vendoste objektiva për të cilat nuk kishte plan. Ai bëri premtime që nuk i mbajti. Bota këto gjëra i vuri re. Armiqtë testuan. Aleatët u neglizhuan, deri kur për këta lindi sërish nevoja, për t’iu kundërvënë prerësve të kokave që flisnin për një Kalifat dhe e quanin veten shtet.

Fjalë të tilla si “forcë” dhe “vendosmëri” u rikthyen në fjalorin e udhëheqësit. Por bota ishte tashmë e paankoruar, e zgjidhur prej tërheqjes së fuqisë që ruante rendin. Libri i rregullave ishte grisur.

Ishte një kohë urrejtjeje. Sloganë antisemitë nisën të dëgjohen në vendin që krijoi vrasjen masive të industrializuar për hebrejtë e Europës. Hebrejtë





e frikësuar europianë hoqën mezuzah-ët nga shtëpitë e tyre. Myslimanët e Europës nisën të ndiejnë kundërgoditjen dhe hakmarrjen e shëmtuar për mëkatet e prerësve të kokave, që ishin të zotë për ta dërguar nëpër Facebook mesazhin e tyre. Struktura e shoqërisë nisi të tensionohet. Politikanët, të përndjekur prej paaftësisë së tyre, nisën të luajnë me frikërat e popull-sive të tyre. Distopia (e kundërta e utopisë) ishte një fjalë në modë, ashtu si utopia në shekullin 20. Kombet e mëdhenj në ngjitje, me popullsi të mëdha, kishin në duart e tyre fatet e botës, por ata as që donin t'ia dinin. Ishte një kohë ethesh. Në Afrikën Perëndimore, njerëzve u dilte gjak nga sytë.

Ishte një kohë corientimi. Askush nuk i “bashkonte më pikat”, apo lexonte Kiplingun për ato pak siguri që ka jeta: “Qeni rikthehet tek e vjella e tij dhe dosa rikthehet në llucën e saj / dhe gishti i fashuar i budallait, rikthehet për t’u tundur tek zjarri”.

Deri kur ishte shumë vonë, njerëzit nuk mund ta shihnin Shturjen e Madhe për atë që ishte dhe për atë që kishte shkaktuar. /NYT/

www.asp.al



www.bota.al